



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2437, datë 27.03.2014

Për

“Miratimin e Dokumentit: “Analizë e tregut të shumicës të terminimit të SMS-ve në rrjetet e telefonisë së levizshme – Dokumenti Përfundimtar”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 27.03.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e Dokumentit: “Analizë e tregut të shumicës të terminimit të SMS-ve në rrjetet e telefonisë së levizshme – Dokumenti Përfundimtar ”

mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Grupi i Punës, të përbërë nga:

i. Relacioni shpjegues;

ii. Dokumenti *“Analizë e tregut të shumicës të terminimit të SMS-ve në rrjetet e telefonisë së levizshme – Dokumenti Përfundimtar”*

iii. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485.

BAZA LIGJORE:

- 1) Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
- 2) Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
- 3) Ligji nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- 4) “Rregullore per analizen e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, date 17.07.2009, ndryshuar me vendimin nr. 2342, date 31.07.2013, te Keshillit Drejtues te AKEP (**Rregullorja**).
- 5) Vendim Nr.2374, datë 30.10. 2013, Për “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: *“Analizë e tregut të shumicës të terminimit të SMS-ve në rrjetet e telefonisë së levizshme – Dokumenti Keshillim Publik”*”

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projekt-Vendimi për “*Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut të shumicës të terminimit të SMS-ve në rrjetet e telefonisë së levizshme – Dokumenti Perfundimtar”*”
2. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**),
3. Komentet e palëve të interesuara për dokumentin “*Analizë e tregut të shumicës të terminimit të SMS-ve në rrjetet e telefonisë së levizshme – Keshillim Publik*”:
 - Albtelecom sh.a me shkresën Nr. 3 Prot., datë 06.01.2014;
 - Vodafone Albania sh.a. nëpërmjet shkresës Nr. 2184 Prot., datë 30.12.2013 ;
 - Albanian Mobile Communications sh.a. me shkresën Nr. 2196 Prot., datë 30.12.2013;
 - Plus Communication Sh.a nepermjet shkrese Nr. 2195 date 30.12.2013;
4. Dokumenti i përgatitur nga Grupi i Punës “*Analizë e tregut të shumicës të terminimit të SMS-ve në rrjetet e telefonisë së levizshme – Dokumenti Perfundimtar*”, i cili përmban si Aneks 1: *Komentet në Keshillim Publik dhe Qëndrimi i AKEP për komentet;*

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V E R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP miratoi me Vendim Nr.2374, datë 30.10. 2013, Për “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: *“Analizë e tregut të shumicës të terminimit të SMS-ve në rrjetet e telefonisë së levizshme – Dokumenti Këshillim Publik”*”
2. Këshillimi publik u krye më datë 31.10.2013-30.12.2013, dhe nga palët e interesuara kanë dërguar komente operatorët Albtelecom, Albanian Mobile Communication, Vodafone Albania, Plus Communications sh.a.
3. Dokumenti *“Analizë e tregut të shumicës të terminimit të SMS-ve në rrjetet e telefonisë së levizshme – Dokumenti Perfundimtar”*
 - a. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar më 31.10.2013-30.12.2013, dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet (Aneks 2, i dokumentit) në përputhje me nenin 35 të Ligjit 9918 i ndryshuar;
 - b. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë të të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
 - c. nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizen e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918 i ndryshuar, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës dhe analizën e testit të tre kritereve, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
 - d. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Europian dhe praktikat më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Europian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular;
 - e. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918 i ndryshuar, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918 i ndryshuar.

A T E H E R E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën ç) të nenit 8 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S:

1. Të miratojë Dokumentin “Analizë e tregut të shumicës të terminimit të SMS-ve në rrjetet e telefonisë së levizshme – Dokumenti Perfundimtar”, sipas përmbajtjes në Aneks 1.
2. Dokumenti i miratuar në pikën 1 të publikohet në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al.
3. Kundra ketij vendimi, mund të bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit përkatës.
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE

Ankes 1



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZË

E

TREGUT

Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të lëvizshme

Dokument Perfundimtar

Mars 2014

(MIRATUAR ME VKD NR.2437 DATE 27.03.2014)

PUBLIKUAR NE www.akep.al ne seksionin Konsultime te Perfunduara



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZË
E
TREGUT

Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të lëvizshme

PERFUNDIMTARE

MARS 2014

(MIRATUAR ME VKD NR.2437 DATE 27.03.2014)

INDEKSI I PËRMBAJTJES

I. PËRMBLEDHJE	4
II. HYRJE	7
II.1. PANORAME E SEKTORIT TE TELEFONISE CELULARE	7
II.2. PERFUNDIMET KRYESORE TE ANALIZES 2011 PER TERMINIMIN E SMS-VE	11
III. TERMINIMI I SMS-VE NE RRJETET CELULARE.....	13
III.1. TREGU ME PAKICË I SMS-VE.....	13
<i>Perdorimi i SMS-ve.....</i>	<i>13</i>
<i>Tarifimi i SMS-ve me pakice</i>	<i>16</i>
<i>Perfundim per tregun me pakice te SMS-ve ne Shqiperi.....</i>	<i>17</i>
III.2. PERKUFIZMI I TREGUT TE TERMINIMIT TE SMS-VE.....	18
III.3 APLIKIMI I TESTIT TË TRE KRITEREVE.....	21
III.4 ANALIZA PËR FUQI TË NDJESHME NË TREG	25
I. <i>Përvoja rregullatore në vendet e rajonit dhe të BE-së</i>	<i>27</i>
II. <i>Përfundime mbi fuqinë e ndjeshme në tregun e analizuar.....</i>	<i>30</i>
III.IV. MASAT RREGULLUESE NE TREGJET ME SHUMICE TE TERMINIMIT TE SMS-VE	31
ANEKS 1. KOMENTET NE KESHILLIM PUBLIK DHE QENDRIMI I AKEP.....	33

INDEKSI I TABELAVE DHE FIGURAVE

FIGURA III.4.1 TARIFAT E TERMINIMIT TË SMS-VE NË VENDET TE NDRYSHME (2013)	41	3
FIGURA III.4.2 ECURIA E TARIFAVE TE TERMINIMIT TË SMS-VE (SIPAS RREGULLIMIT)	41	3
FIGURA II.1 ECURIA E NUMRIT TË PËRDORUESVE CELULARË AKTIVE 2010-2013/1		8
FIGURA II.2 ECURIA E NUMRIT TË PËRDORUESVE CELULARË “AKTIVE” DHE SIM 2010-2013/1		8
PJESËT E TREGUT TË OPERATORËVE CELULARË (2010-2013/1)		9
TABELA II.1: PJESËT E TREGUT TË OPERATORËVE CELULARË (2010-2013/1)		9
<i>REDUKTIMI I PËRSHKALLËZUAR I TARIFAVE TË TERMINIMIT TË SMS-VE NE RRJETET CELULARE PËR ORIENTIM NË KOSTO BU-LRAIC</i>		12
FIGURE III .1 ECURIA E NUMRIT TOTAL TE MESAZHEVE SMS TE DERGUARA NGA ABONENTET CELULARE.....		14
2008-2013/1 (NE MILION)		14
TABELA III .1 ECURIA E PJESEVE TË TREGUT TË OPERATORËVE PËR SMS 2008-2013/1		14
TABELA III .2 ECURIA E PERDORIMIT MESATAR TE SMS-VE 2011-2013/1		15
TABELA III .3 ECURIA E PERDORIMIT MESATAR TE DISA PREJ SHERBIMEVE CELULARE PER 2011-2013/1		15
FIGURA III.4.1 TARIFAT E TERMINIMIT TË SMS-VE NË VENDET TE NDRYSHME (2013)		41
FIGURA III.4.2 ECURIA E TARIFAVE TE TERMINIMIT TË SMS-VE (SIPAS RREGULLIMIT)		41

I. PËRMBLEDHJE

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 “Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar këtu e me pas Ligji nr. 9918, i ndryshuar, ne nenin 1 te tij, percakton se:

“Qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë efëçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Ky dokument përmban analizën e tregjeve me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike të telefonisë së lëvizshme, tregje te cilat analizohen per here te dyte nga AKEP, pas analizes te perfunduar ne 2011.

Konkretisht tregjet e analizuar jane:

- Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të lëvizshme

Ne baze te percaktimeve te Ligjit 9918, i ndryshuar si dhe praktikes se AKEP me analizat e tregjeve, periudha e konsultimit publik u mbajt prej 60 ditesh nga data 31.10.2013 deri me 30.12.2013, dhe procesi i konsultimit u krye per statusin e FNT si dhe per detyrimet e propozuara per FNT. Ne perfundim te periudhes se konsultimit nga palet e interesuara kane derguar komente ne lidhje me kete dokument operatoret Altelecom Sh.a, Albanian Mobile Communication, Plus Communications dhe Vodafone Albania. Komentet mbi dokumentin si dhe qendrimet e mbajtura rreth ketyre komenteve nga AKEP jane te reflektuara ne dokumentin e analizes ne seksionin e fundit, “ANEKS 1”.

Nga analiza e tregut me pakice per sherbimin e SMS, rezulton qe ne treg ka nje numer te madh te ofertave (plane tarifore te ndryshme) per SMS me cmime te uleta (bundles), por ne te njejten kohe vihet re tarifat standarte te SMS-ve jane ne nivele te larte qe variojne midis operatoreve, duke arritur dhe ne 17 leke/SMS. Pra sherbimi SMS-ve ne tregun e pakices ka zhvillim pozitiv te konkurrences, por akoma vazhdon te kete probleme qe deformojne konkurrencen efektive, probleme te cilat zvogelojne mundesite reale per perfitimin e mundshem te konsumatorit ne lidhje me kete sherbim.

Tregu me shumicë i terminimit të SMS-ve, nuk është pjesë e listës së tregjeve të Rekomandimit të Komisionit European, të vitit 2003 apo të vitit 2007, si dhe nuk është pjesë e listës së tregjeve në Rregulloren e Analizës së Tregut, e ndryshuar. Megjithatë rregullorja, ashtu si edhe rekomandimet e KE, parashikojnë që AKEP mund të analizojë tregje që nuk janë pjesë e listës së tregjeve të justifikuar për ndërhyrje ex-ante apo për kryerjen e analizes se tyre. Në përputhje me përcaktimet e rregullores, para analizes të tregut të terminimit të SMS-ve për FNT, AKEP fillimisht ka analizuar nese ky treg ploteson testin e tre kriterëve. Pas aplikimit te testit te tre kriterëve per tregun me shumice te terminimit te SMS-ve, rezulton se Tregu me shumice i terminimit te SMS-ve, permbush Kriteret 1, 2 dhe 3, keshtu qe ne baze te Rekomandimit te KE, ky treg justifikon rregullimin ex-ante nga ana e AKEP, rrjedhimisht eshte e nevojshme te analizohet per FTN;

Nga analiza për përkufizimin e tregjeve përkates të terminimit të SMS-ve në rrjetet celulare rezulton se tregu perkatës i terminimit të SMS-ve në rrjetet celulare është terminimi i SMS-ve në rrjetet individuale celulare, pra një treg për secilin operator celular. Dimensioni gjeografik i tregjeve të terminimit të SMS-ve në secilin rrjet celular është territori i Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në vlerësimin e faktoreve të evidentuar, në lidhje me shërbimin e terminimit të SMS-ve, për secilin nga operatorët e telefonisë së levizshme, në rrjetet individuale të tyre, rezulton se secili sipërmarres ka FNT në terminimin e SMS-ve në rrjetin e vet. Kriteret e marra në shqyrtim nuk priten të ndryshojnë të paktën në një periudhë afatmesme, në mënyrë që të eliminojnë aftësinë ndikuese të operatorëve në tregjet përkates të terminimit të SMS-ve;

AKEP në analize ka trajtuar edhe disa faktore të tjera, që kanë të bëjnë kryesisht me:

- Asimetritë e trafikut të zhvilluar (volumit të SMS-ve të shkëmbyera) ndërmjet rrjeteve si marrëdhënie interkoneksioni ndërmjet tyre dhe mundësitë egzistuese për shtremberime të konkurrencës;
- Efektet e rrjetit tek shërbimi i terminimit të SMS-ve, paketat “Bundles” (brenda rrjetit dhe kryesisht në grupet mbyllura);
- Efektet e mundshme të masave rregullatore në nivelin shumicës dhe transferimi i tyre në tregjet e pakicës;

Në përfundim të përkufizimit të tregut përkates dhe analizës për FNT rezulton se:

- Operatori Vodafone Albania përmbush kriteret e sipërmarresit me FNT në tregun e terminimit të SMS-ve në rrjetin celular Vodafone Albania.
- Operatori AMC përmbush kriteret e sipërmarresit me FNT në tregun e terminimit të SMS-ve në rrjetin celular AMC.
- Operatori Altelecom sh.a përmbush kriteret e sipërmarresit me FNT në tregun e terminimit të SMS-ve në rrjetin celular Altelecom sh.a.
- Operatori Plus Communication përmbush kriteret e sipërmarresit me FNT në tregun e terminimit të SMS-ve në rrjetin celular Plus Communication.

Pas përfundimit të keshillimit publik të dokumentit të analizës AKEP gjykon të arsyeshme për vazhdimin e aplikimit të masave rregullatore aktuale të përcaktuara sipas analizës 2011, duke bërë disa ndryshime:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39);
2. Detyrimi i transparencës (neni 40);
3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (neni 42);
4. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (neni 45);

Nga detyrimet e vendosur në 2011, AKEP ka vendosur të heqë detyrimin për ndarje të llogarive, ndërsa për rregullimin e tarifave të terminimit të SMS-ve, të aplikojë vetëm një reduktim sipas

tabeles se meposhteme, duke ruajtur simetrine midis tarifave te kater operatoreve dhe reduktuar tarifen me 31%. Afati i fillimit te aplikimit te tarifave se re te terminimit te SMS-ve do te jete data 1.04.2014, e njejte me daten e fillimit te reduktimit te tarifave te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare te percaktuar nga AKEP ne dokumentin dhe vendimet perkatese per “*Rishikimin e tarifave te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare*”.

	Aktuale - 31 Mars 2014	1 Prill 2014- ne nje vendim tjeter te AKEP
Vodafone		
AMC		
Albtelecom (EM)	1.44	1.00
Plus Communication		

Tarifat në Lek/SMS pa TVSH

Vleresohet se kjo mase rregullatore do te mundesoje nje mjedis me te ekuilibruar ndermjet operatoreve duke krijuar stimuj me te rritur per ofrim tarifash me te lira ne nivel me pakice, sidomos per tarifate standarte/nominale (jo te perfshira ne bundles) per SMS jashte rrjetit (off-net).

II. HYRJE

II.1. Panorame e sektorit te telefonise celulare

Në fund të vitit 2013, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme sipas kartave SIM aktive, arriti në 5.3 milion krahasuar me 5.6 milion në fund të vitit 2012. Ndryshimi përbën një rënie vjetore prej 6%, dhe ai varion sipas operatorëve: AMC dhe Vodafone kanë rritje me 10 dhe 11%, Plus ka rritje të vogël me 2%, ndërsa Albtelecom (Eagle Mobile) ka rënie të ndjeshme me 52%. Rënia e madhe e numrit të përdoruesve celularë të EM përbën edhe arsyen e rënies për herë të parë të këtij treguesi, që prej fillimit të shërbimeve celulare në Shqipëri në 1996. Reduktimi i madh i këtij treguesi për EM vjen për shkak të ndryshimit të mënyrës së raportimit të numrit të kartave SIM aktive nga Eagle Mobile¹.

Figura 2, paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë sipas kartave SIM në periudhën 2000-2013, Figura 3, paraqet numrin e përdoruesve celularë sipas dy treguesve: 'përdorues aktivë' dhe 'karta SIM aktive'. Proporcioni i përdoruesve aktive ndaj kartave SIM aktive është në nivel 70% për të katër operatorët së bashku, duke variuar nga 63% për EM në 74% për Vodafone. Ndryshimin më të madh të këtij proporcioni e ka EM, nga 31% në fund të 2012 në 63% në fund të 2013 (shiko shënimin për arsyen e këtij ndryshimi të madh), raport që është i ngjashëm me atë të tre operatorëve të tjerë.

Numri i përdoruesve celularë aktivë në fund të vitit 2013 arriti në 3.7 milion, krahasuar me 3.5 milionë në fund të vitit 2012. Kjo përbën një rritje vjetore me 4% për të katër operatorët, ndërkohë që norma e rritjes ndryshon sipas operatorëve: Plus dhe Vodafone kanë rritje me 9 dhe 11% respektivisht, ndërsa Albtelecom (EM) dhe AMC kanë reduktim 2 dhe 3% respektivisht. Figura 2, paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë aktivë në periudhën 2010-2013.

Figura II.1, paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë aktive në periudhën 2010-2013, ndërsa figura II.2, paraqet numrin e pajtimtarëve celularë sipas dy treguesve: 'përdorues aktivë' dhe 'karta SIM aktive'. Proporcioni i përdoruesve aktive ndaj kartave SIM aktive është në nivel 69% për të katër operatorët së bashku, duke variuar nga 64% për AMC në 74% për Vodafone.

Ndryshimin më të madh të këtij raporti e ka EM, nga 31% në fund të 2012 në 70% në fund të gjashtëmujorit të parë 2013 (shiko shënimin për arsyen e këtij ndryshimi të madh). Pjesët e tregut të operatorëve sipas dy treguesve janë të përafërta, dhe Vodafone Albania zoteron 46% për përdorues aktivë dhe 43% për karta SIM. AMC zoteron 37% për përdorues aktivë dhe 40% për karta SIM, ndërsa EM dhe Plus kanë respektivisht 10% dhe 7% pjesë tregu për të dy treguesit.

¹ EM deri në fund të vitit 2012 ka raportuar për këtë tregues vlerën kumulative të kartave SIM të shitura që prej fillimit të aktivitetit të tij deri në fund të periudhës përkatëse, ndërsa duke filluar nga gjashtëmujori i parë 2013, EM ka rivlerësuar numrin e pajtimtarëve duke i'u referuar vetëm kartave SIM aktive në fund të periudhës përkatëse.

FIGURA II.1 ECURIA E NUMRIT TË PËRDORUESVE CELULARË AKTIVE 2010-2013





FIGURA II.2 ECURIA E NUMRIT TË PËRDORUESVE CELULARË “AKTIVE” DHE SIM 2010-2013



Burimi: Të dhënat periodike të operatorëve.

PJESËT E TREGUT TË OPERATORËVE CELULARË (2010-2013)

Pjesët e tregut të operatorëve celularë janë vlerësuar në disa prej treguesve kryesore sipas të dhenave të depozituara në AKEP, të cilat janë të paraqitura sipas tabelës të mëposhtme dhe që përmbajnë pjesë tregu për:

Perdorues Aktive; Përdorues (Karta SIM); Përdorues me Kontratë; Thirrje dalese; SMS dhe Te ardhura (të ardhurat për vitin 2012).

Nga vlerësimi i pjesëve të tregut për 6 mujorin e I-re 2013 për zerat: Përdorues Aktive; Përdorues (Karta SIM); Përdorues me Kontratë; Thirrje dalese dhe SMS në total, rezultojnë që ka një rënie pjesëve të tregut për AMC dhe Eagle Mobile në numrin e përdoruesve aktivë në rreth 3 % dhe 2 % përkatësisht si dhe një rritje të numrit të përdoruesve aktivë për Vodafone Albania dhe Plus Communications përkatësisht në vlerat 4 % dhe 1%. Krahasimi është bërë për 2013/1 dhe fund vitin 2012.

Ndërsa në lidhje me treguesit për thirrjet dalese situata paraqitet pothuajse e njëjta krahasuar me fund vitin 2012, duke reflektuar një rënie të vogël për Eagle Mobile si dhe një rritje jo të konsiderueshme për Plus Communication (vlera e ndryshuar është në 1%, për secilin nga ndryshimet e cituara).

Vlen të theksohet që në vlerësimin e pjesëve të tregut për thirrjet dalese janë të përfshira edhe thirrjet on-net.

Në lidhje me pjesët e tregut për SMS dalese, rezultojnë që nuk ka asnjë ndryshim nga të dhënat e vitit 2012, pjesët e tregut për secilin nga operatorët janë të pandryshuara gjatë kësaj periudhe.

TABELA II.1: PJESËT E TREGUT TË OPERATORËVE CELULARË (2010-2013)

		AMC	VODAFONE ALBANIA	EAGLE MOBILE	PLUS COMMUNICATION
Përdorues Aktivë	2013	37%	45%	12%	6%
	2012	40%	42%	12%	6%
	2011	37%	44%	13%	6%
	2010	44%	36%	19%	1%
Përdorues (Karta SIM)	2013	39%	42%	13%	6%
	2012	33%	36%	25%	6%
	2011	37%	35%	21%	8%

	2010	44%	37%	18%	1%
Përdorues me Kontratë	2013	37%	22%	21%	20%
	2012	31%	18%	36%	15%
	2011	35%	24%	34%	7%
	2010	43%	30%	27%	-
	2013	39%	51%	7%	3%
Thirrje dalëse	2012	39%	50%	8%	3%
	2011	37%	51%	10%	2%
	2010	46%	45%	9%	-
SMS	2013	21%	73%	5%	1%
	2012	20%	73%	6%	1%
	2011 ²	27%	64%	8%	1%
	2010	34%	57%	9%	-
Të ardhura	2012	29%	56%	10%	5%
	2011	34%	52%	12%	2%
	2010	40%	48%	12%	-

² Pjesët e tregut për SMS për vitin 2011 të publikuara më parë janë korrigjuar. Lexuesi lutet t'i referohet këtyre vlerave të rishikuara për SMS për vitin 2011.

II.2 Perfundimet kryesore te analizës 2011 per terminimin e SMS-ve

Tregu me shumicë i terminimit të SMS-ve, u analizua si nje treg qe nuk bente pjesë ne Listën e tregjeve të Rekomandimit të Komisionit European, të vitit 2003 apo të vitit 2007. Në përputhje me përcaktimet e rregullores se analizës se tregut, para analizimit të tregut të terminimit të SMS-ve për FNT, AKEP fillimisht ka aplikuar testin e tre kriterëve, duke provuar qe testi plotësohej.

Percaktimi i tregut perkates

Ne lidhje me percaktimin e tregut perkates si dhe përkufizimin e tregjeve përkates të terminimit të SMS-ve në rrjetet celulare rezultoi se:

- *Tregu i terminimit të SMS-ve në rrjetin celular AMC, shërbim i ofruar nga sipërmarrësi AMC sh.a;*
- *Tregu i terminimit të SMS-ve në rrjetin celular Vodafone Albania, shërbim i ofruar nga sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a;*
- *Tregu i terminimit të SMS-ve në rrjetin celular Eagle Mobile, shërbim i ofruar nga sipërmarrësi Eagle Mobile sh.a;*
- *Tregu i terminimit të SMS-ve në rrjetin celular Plus Communications, shërbim i ofruar nga sipërmarrësi Plus Communication sh.a;*

Dimensioni gjeografik i tregjeve të terminimit të SMS-ve në sejcilin rrjet celular është territori i Republikës së Shqipërisë.

Analiza per FNT

Në analizën e faktorëve të marrë në konsideratë për fuqinë e ndjeshme në tregjet perkatese, u konkludua se:

- *Secili prej operatoreve celularë zoteron 100 për qind te tregut të terminimit të SMS-ve në rrjetet e tyre;*
- *Operatorët celulare nuk perballen me kercenimin e hyrjes në tregjet e tyre të terminimit të operatorëve të tjerë, që do te ishin të aftë të kryenin edhe terminimin e SMS-ve në keto rrjete;*
- *Fuqi të ulët kundervepruese, ose e paperfillshme nga operatorët e rrjeteve të tjera dhe ofrues shërbimesh të internetit;*
- *Kriteret e marra në shqyrtim nuk pritët të ndryshojnë të paktën në një periudhe afatmesme, në menyrë që të eliminojnë aftësinë ndikuese të operatorëve në tregjet përkates të terminimit të SMS-ve.*

Bazuar ne sa siper, AKEP vleresoi se: operatorët Vodafone Albania, AMC, Eagle Mobile dhe Plus Communication përmbushnin kriteret për fuqi të ndjeshme në tregjet perkatese të terminimit të SMS-ve në rrjetet e tyre celulare, individualisht ne secilin nga rrjetet perkatese.

AKEP ka vleresuar si analoge problemet e mundshme ne tregjet e terminimit per te dy sherbimet baze ne rrjetet e telefonise se levizshme, sherbimin e terminimit te thirrjve zanore si dhe sherbimin e terminimit te SMS-ve.

Keshtu, qe ne analize 2011, me qellim eliminimin e problemeve te mundshme te identifikuara, AKEP percaktoi masat rregulluese dhe detyrimet për operatorët me FNT në rrjetet e terminimit të SMS-ve në rrjetet celulare, duke vendosur konkretisht:

- 1) Detyrimi i Mosdiskriminimit*
- 2) Detyrimi i transparencës*
- 3) Detyrimi për akses dhe interkoneksion si dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit*
- 4) Detyrimi për kontroll të tarifave dhe orientim në kosto*

Ne lidhje me detyrimin per kontrollin e tarifave, AKEP ka percaktuar nje skedul kohor me vlerat perkatese, ne te cilen jane dhene afatet dhe niveli maksimal i tarifave te terminimit te mesazheve SMS nen rregullim, per tu aplikuar nga kater operatoret me FNT, te percaktuar si te tille sipas analize 2011. (sipas tabelës se meposhtme)

TABELA III. _REDUKTIMI I PËRSHKALLËZUAR I TARIFAVE TË TERMINIMIT TË SMS-VE NE RRJETET CELULARE PËR ORIENTIM NË KOSTO BU-LRAIC

	Para rregullimit	1 Janar 2012	1 Shtator 2012	1 Shtator 2013
AMC Vodafone EM Plus Communication	3	2.4	2	1.44

Tarifat në Lek/SMS pa TVSH

III. TERMINIMI I SMS-ve NE RRJETET CELULARE

Ne analizen pararendese ne lidhje me sherbimin e terminimit te SMS-ve, eshte konsideruar se ky sherbim me shumice ka analogji me sherbimin e terminimit te thirrjeve zanore te pershkruar dhe analizuar ne menyre te detajuar ne tre raunde te analizave te tregut per telefonine e levizshme.

Keshtu qe ne percaktimin e bere per sherbimin e terminimit te SMS-ve si nje sherbim me shumice, per te cilin cdo operator rrjeti celular e ofron per operatore te tjere ne menyre qe abonentet e ketyre operatoreve te mund te dergojne SMS drejt aboneteve te ketij rrjeti celular.

AKEP ne analogji edhe me analizat e tjera te kryera ne tregjet e shumices edhe ne kete proces analize te ketij tregu, fillimisht do te behet nje vleresim i tregut te lidhur vertikalisht me tregun me shumice te terminimit te SMS-ve, dhe konkretisht tregun me pakice te SMS-ve ne Shqiperi.

III.1. TREGU ME PAKICË I SMS-VE

AKEP ka vleresuar ofrimin me pakice te mesazheve SMS, duke e konsideruar si nje nder sherbimet celulare me te rendesishme pas thirrjeve telefonike celulare dhe ne vijimesi ne te gjitha raportet periodike te publikuara ka referuar edhe vleresimin perkates mbi perdorimin e ketij sherbimi nga konsumatorët e sherbimeve te ofruara nga rrjetet e telefonise se levizshme.

Ne analizen pararendese, AKEP ka trajtuar konkurrencen ne tregun e pakices per sherbimin e SMS-se dhe ne menyre analoge edhe ne kete dokument, do kete nje vemendje te vecante zhvillimi i konkurrences ne kete treg.

Keshtu qe ne vijimesi do te evidentohen treguesit kryesore per kete sherbim, ecuria e tij ne periudhen 2011-2013 si dhe parashikimet e mundshme per periudhat ne vazhdim.

Perdorimi i SMS-ve

SMS-te si nje nder sherbimet baze te telefonise se levizshme, kane nje vemendje te vecante ne ofrimin e bere nga te kater rrjetet e telefonise se levizshme, sherbim i cili ofrohet ne nje numer te madh ofertash dhe planesh tarifore si dhe ne paketa standarte.

Ofertat e mundshme ne treg, pavaresisht ndryshimeve qe mund te kene nga njeri rrjet ofrues ne tjetrin, ne teresine e tyre permbajne te integruara pothuajse ne menyre te ngjashme nje grup elementesh qe ne menyre te permbledhur jane:


- Grup thirrjesh dhe grup SMS brenda grupit pa asnjë limit;
- Bllok të integruar me minuta kombëtare;
- Bllok të integruar me SMS kombëtare ;
- Bllok të integruar për navigim në Internet ;

dhe ne shumicen e tyre ofrojne dhe blloqe te integruara me minuta ndërkombëtare , te cilat mund te jene opsionale.

Persa i perket rendesise se strukturimit ne shperndarjen e tyre, vemendje te vecante te kater operatoreve celulare i kushtojne konsolidimit te grupeve te mbyllura (brenda grupit) dhe me pas fokusohen ne elementet favorizues brenda rrjetit.

Ne figuren e meposhtme paraqitet ecuria e numrit te mesazhve SMS te derguara nga abonentet e rrjeteve celulare ne periudhen 2008-2013.

FIGURE III .1 ECURIA E NUMRIT TOTAL TE MESAZHEVE SMS TE DERGUARA NGA ABONENTET CELULARE 2008-2013 (NE MILION)



Burimi: Te dhenat periodike zyrtare te derguara ne AKEP

Nga figura dhe tabela e te dhenave konstatohet qe per te kater rrjetet e telefonise se levizshme, periodikisht vijon rritja e numrit te SMS-ve te derguara (ne totalin e tyre) edhe per periudhen 2011-2013. Rritja e volumit te SMS-ve ka ardhur kryesisht jo vetem si pasoje e prezences se kater rrjeteve celulare, por faktori percaktues ne kete rritje ka te beje me shtimin e paketave tarifore per SMS-te si brenda rrjetit (on net) dhe jashte rrjetit (off net).

Tabela e meposhtme paraqet ecurine e pjeseve te tregut te operatoreve celulare per numrin e SMS-ve te derguara (ne total), nga abonentet e tyre per periudhen 2008-2013

TABELA III .1 ECURIA E PJESEVE TË TREGUT TË OPERATORËVE PËR SMS 2008-2013

	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Vodafone Albania	64.40%	49.60%	56.50%	74%	73%	73%
AMC	31.00%	35.70%	34.20%	17%	20%	21%
Eagle Mobile	4.60%	14.70%	9.20%	9%	6%	5%

Plus Communication		0.08%	1%	1%	1%
---------------------------	--	-------	----	----	----

Burimi: Të dhënat periodike zyrtare të dërguara në AKEP

Nje nga treguesit e tjere te konsideruar si te rendesishem eshte edhe perdorimi mesatar i sherbimeve (perfshire sherbimin e SMS-ve). AKEP, kete tregues e ka paraqitur ne vijimesi ne raportet statistikore te publikuar ne menyre periodike dhe kjo eshte vleresuar sipas SIM kartave aktive (ne total) si dhe sipas perdoruesve aktive.

Ne tabelen e meposhtme paraqitet ecuria e perdorimit mesatar te SMS-ve, e matur si numri i SMS-ve te derguara mesatarisht nga nje abonent celular gjate nje muaji, duke e llogaritur sipas SIM kartave aktive (ne total), si dhe sipas perdoruesve aktive.

TABELA III .2 ECURIA E PERDORIMIT MESATAR TE SMS-VE 2011-2013

	2011	2012	2013
SMS (dalëse) ne muaj (SIM karta aktive totale)	12	21	24
SMS (dalëse) ne muaj (perdorues aktive)	19	35	39

Burimi: Te dhënat periodike zyrtare te dërguara ne AKEP

Per te vleresuar aspektin e zevendesueshmerise se kerkeses ne tregun e pakices per sherbimet e telefonise se levizshme (thirrjet zanore dhe SMS), duke mos perjashtuar edhe karakteristikat funksionale ndermjet dy sherbimeve te citura (perputhshmeria e tyre, ose jo) treguesi i perdorimit te ketyre sherbimeve shpreh ne menyre me bindese efektin zevendesueshmerise ne perdorimin e SMS-ve ne vend te thirrjeve telefonike , pa analizuar arsyet qe mund te jene marre ne konsiderate nga perdoruesi per te bere zevendesimin e ketyre dy sherbimeve (thirrje zanore me SMS).

Tabela e meposhteme paraqet ecurine e treguesve kryesore te perdorimit mesatar te disa prej sherbimeve celulare per 2011-2013, te llogaritura edhe sipas SIM kartave aktive (ne total), si dhe sipas perdoruesve aktive.

TABELA III .3 ECURIA E PERDORIMIT MESATAR TE DISA PREJ SHERBIMEVE CELULARE PER 2011-2013

	2011	2012	2013
Përdorues Aktive			
Thirrje dalëse në muaj	130	152	156
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	147	168	167
MOU*	277	320	323
SMS (dalëse) në muaj	19	35	39

Përdorues Karta SIM			
Thirrje dalëse në muaj	83	93	103
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	94	103	111
MOU*	177	196	214
SMS (dalëse) në muaj	12	21	26

Burimi: Te dhenat periodike zyrtare te derguara ne AKEP

Siç mund të vihet re nga tabela edhe për vitin 2013 është vënë re një rritje e përdorimit mesatar mujor për përdorues të shërbimeve celulare. Gjatë vitit 2013, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 156 minuta thirrje dalëse dhe ka marrë 167 minuta thirrje hyrëse, duke rezultuar në 324 minuta komunikim thirrje telefonike në muaj dhe ka dërguar 39 SMS në muaj. Këto vlera përdormi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit të kartave SIM aktive: 103 minuta dalëse, 111 minuta hyrëse dhe 214 minuta komunikim thirrje dhe 26 SMS në muaj.

Tarifimi i SMS-ve me pakice

Ne analizen pararendese AKEP ka trajtuar tarifimin e SMS-ve me pakice, duke marre ne konsiderate nje grup faktoresh qe lidhen me nivelin e perdorimit te SMS-ve, si dhe duke referuar nje permbledhje informacioni mbi tarifimin e bere nga te kater rrjetet celulare per te dy kategorite e perdoruesit (me parapagim dhe me kontrate).

Edhe ne kete dokument analize, ne vijim do te trajtohet tarifimi i SMS-ve me pakice, ecuria e tarifimit per periudhen 2011-2013/1, krahasimi sipas kategorive kryesore, pasi sherbimi i SMS-ve ofrohet nga nje numer i madh planesh tarifore te trajtuara ne “bundles”, te cilat gjithnje e me shume zvoglojne mundesite e krahasimit te tarifimit si nje SMS standart.

Kjo nuk eshte vecori vetem e tregut shqiptar, por eshte nje fenomen gjeresisht i perdorur ne te gjithë boten, dhe ne kete aspekt ka nje sere faktoresh qe duhen konsideruar si:

- thirrjet telefonike (me tarifa me te uleta se tarifa SMS);
- grup moshat e perdoruesve (barrierat e gjuhes);
- perdorimi i rrjeteve sociale (Facebook, Tweeter, WhatsApp, Viber...etj si dhe aplikacione te tjera te internetit);

Ky grup faktoresh, i kombinuar ne politika te marketingut te brendshem te cdo kompanie, ndikojne edhe ne tarifimin e SMS-ve, si dhe orientojne marketingun e rrjeteve celulare drejt ndertimit te planeve tarifore (oferta te natyres agresive), duke ofruar ne treg plane tarifore me tendence favorizimin e grupeve te mbyllura, duke konsoliduar ne kete menyre bazen e pajtimtareve te rrjetit.

Ne krahasimin e tarifimit te SMS-ve ne tregun e pakices, do te konsiderohen kategorite kryesore sipas te cilave eshte bere edhe strukturimi i ofertave te operatoreve ne treg dhe kryesisht:

- Numri i madh i paketave dhe planeve tarifore;
- Frekuenca e shpeshte e nderrimit te tyre;
- Veshitresite serioze te krahasimit te elementeve perberes;

Keto elemente te marra se bashku, krijojne nje konfuzion te madh tek perdoruesi, duke e bere te veshtire krahasimin apo mundesine e perzgjedhjes edhe per eksperte te fushes, dhe aq me teper per t'u konsideruar si nje opsion i pranueshem per t'u perzgjedhur nga nje perdorues i zakonshem.

Referuar informacionit ne faqet zyrtare te kater rrjeteve celulare, te paketave standarte si dhe planeve tarifore te publikuara sipas struktures se shperndarjes qe kryesisht bejne operatoret celulare, rezulton qe tarifimi i referuar per SMS (shpreh nje variacion tarifash te perdorura) sipas struktures se shperndarjes (brenda grupit, brenda rrjetit, drejt operatoreve te tjere, nderkombetare etj.

Ne vijim paraqitet nje pershkrim i shkurter per dy kategorite kryesore:

- Paketat standarte;
- Paketat sipas ofertave (nje numer i kufizuar i tyre qe do te mjaftonte per ilustrim);

Paketat standarte por edhe ofertat ne treg, pervec strukturimit te tyre te brendshem, kategorizohen edhe ne nje ndarje te dyte, ne parapagese dhe me kontrate, dhe brenda klasifikimit me kontrate egziston nje klasifikim tjeter (individuale dhe biznes).

Duke trajtuar ne nje pershkrim te thjeshtezuar ofertat kryesore per kater rrjetet celulare, AMC, Vodafone Albania, Altelecom Sh.a dhe Plus Communication, e perbashketa e tyre ne ofertat qe gjenden ne treg si dhe diferencat e dukshme ne tarifim krahasuar me paketat standarte te ketyre rrjeteve, vhet re nje analogji ne paketat ofertuese, per te kater rrjetet celulare dhe konkretisht:

- Thirrje (brenda grupit, brenda rrjetit, drejt rrjeteve te tjera, etj);
- SMS (brenda grupit, brenda rrjetit, drejt rrjeteve te tjera, etj);
- Bllok të integruar për navigim në Internet ;

Nje grup i tille produktesh (pjese ne nje pakete ofertuese), veshitresojne ne maksimum mundesine qe te percaktosh ne menyre te sakte tarifen perkatese per secilin nga elementet e ofertes, pasi tarifa reale per secilin nga elementet e paketes se ofertuar do te kushtezohet nga konsumimi i elementeve te ofertes, dhe jo nga sasia e ofertuar.

Nje specifike e tille perfshin te kater rrjetet celulare, dhe kryesisht sherbejne per te fuqizuar lidhjet e rrjeteve perkatese me bazen e pajtimtareve te tyre.

Perfundim per tregun me pakice te SMS-ve ne Shqiperi

Nga pershkrimi (ne menyre te permblledhur per ofertat e operatoreve celulare, "bundles", duke klasifikuar ofrimin e SMS-ve sipas strukturimit (brenda grupit, brenda rrjetit, drejt rrjeteve te tjera kombetare si dhe drejt destinacioneve nderkombetare), rezulton qe:

- Ka nje numer te madh te ofertave (plane tarifore te ndryshme);

- Ne aspektin e perzgjedhjes, shumica e tyre percjellin nje konfuzion te madh per pajtimtaret, duke mos garantuar se zgjedhja e bere prej tyre eshte ajo e duhura ne raport me konsumin e duhur per pajtimtarin;
- Ne tregun e pakices ka zhvillim pozitiv te konkurrences ne sherbimin e SMS-ve, por perseri kjo nuk garanton qe shperndarja e perfitimit te mundshem per pajtimtaret te jete e drejte;
- Nga analiza per paketat standarte te rrjeteve celulare (konstatim edhe nga analiza pararendese), tarifat per SMS standarte eshte e pajustificueshme ne raport me koston reale te SMS-se;
- Konstatohet se nje nder arsyet kryesore ne mbajtjen e tarifave standarte per SMS-te ne nivele te larte, (deri ne 17 leke/SMS), ne varesi te rrjeteve, ka te beje me tendencen e operatoreve per te detyruar pajtimtaret e rrjeteve te tyre te “ngurtesohen” ne grupe te mbyllura;
- Perfitimi i bere nga nje grup pajtimtaresh dhe mungesa e perfitimit nga nje grup tjetër pajtimtaresh (jashte grupeve te mbyllura), duke shtuar konfuzionin dhe paqartesine per te kuptuar elementet perberes te ofertave nga pajtimtari, pasi ka nje diference te madhe ndermjet tarifave standarte te SMS-ve dhe tarifave te SMS-ve te ofruara ne paketat tarifore jo standarte (promocionet, SMS falas brenda grupeve etj), tregon per nje shperndarje jo uniforme te perfitimeve midis perdoruesve celulare, dhe perben diskriminim ne ofrimin e te njejtit sherbim me tarifa te ndryshme;

Keshtu qe duke marre ne konsiderate, konstatimet e mesiperme konkludohet se:

Sherbimi SMS-ve ne tregun e pakices ka zhvillim pozitiv te konkurrences, por akoma vazhdon te kete probleme qe deformojne konkurrencen efektive, probleme te cilat zvoglojne mundesite reale per perfitimin e mundshem te konsumatorit ne lidhje me kete sherbim.

III.2. PERKUFIZMI I TREGUT TE TERMINIMIT TE SMS-VE

AKEP nuk gjykon se eshte e nevojshme perseritje e trajtimeve te bera ne analizen pararendese, pasi do te jete e mjaftueshme per palet e interesuara duke dhene si reference dokumentin pararendes ne faqen zyrtare te AKEP, pasi trajtimi i detajuar per secilen prej tyre gjendet ne:

*“Analizën e tregjeve me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike të telefonisë së lëvizshme” **Dokument Perfundimtar, Shtator 2011** (ne faqen zyrtare te AKEP, www.akep.al ne seksionin **Konsultime te Perfunduara/ arkiva 2011**).*

Trajtim me te detajuar ne kete dokument analize do te behet vetem per ndryshimet e evidentuara nga analiza pararendese, kjo duke marre ne konsiderate analogjine e tregjeve te terminimit per sherbimet baze ne rrjetet e telefonise se levizshme (thirrjet dhe SMS), per te cilat ne vijim do te kete seksione te vecanta.

Duke trajtuar ne menyre te permbledhur parashikimet e Rregullores se Analizes, sipas te ciles analiza nder te tjera përmban:

- përkufizimin e tregjeve përkatëse dhe dimensionin gjeografik te shtrirjes se tyre;

AKEP eshte ne te njejtin qendrim te mbajtur ne analizen pararendese ne lidhje me pershkrimin e produkteve dhe/ose sherbimeve te identifikuar ne tregun perkates te terminimit te SMS-ve, si dhe per dimensionin gjeografik te shtrirjes se ketij tregu.

Ne perkufizimin e tregut te terminimit te SMS-ve ne rrjetet celulare faktoret kryesore, qe çojne ne identifikim te tregjeve te veçante per çdo operator celular, jane konsideruar faktoret si:

a- Praktika, sipas te ciles: pala origjinuese e SMS-se, paguan;

b- Mungesa e zevendesueshmerise se plote te ketij sherbimi, qe mund te ndikonte ne tarifat e sherbimit te terminimit te SMS-ve (ka tendence drejt zevendesimit te pjesshem, por jo te plote per disa nga sherbimet);

c- Ne nivelin me shumice te ofertes dhe kerkeses nuk ka alternativa zevendesimi per sherbimin e terminimit te SMS-ve ne rrjetin e nje operatori celular.

Operatoret nuk kane mundesi tjeter perveçse te blejne terminim te operatorit, ne te cilin jane destinuar SMS-te, te origjinuara nga perdoruesit e vet. Gjithashtu, operatoret e rrjetit celular nuk kane mundesi te ofrojne sherbimin e terminimit te SMS-ve drejt perdoruesve te nje rrjeti tjeter, ne mungese te aksesit ne rrjetin tjeter. Rrjedhimisht, ne perkufizimin e tregut te terminimit te SMS-ve ne rrjetet celulare, nuk mund te perfshihet terminimi ne rrjete te tjera celulare, gje qe do te thote se, qe secili rrjet celular, mundeson krijimin e tregut te terminimit ne rrjetin e tij.

I. Dimensioni i produkteve dhe sherbimeve ne tregun perkates te terminimit te SMS-ve

Ne lidhje me dimensionin e produkteve dhe sherbimeve ne tregun perkates te terminimit te SMS-ve dhe vleresimin ne se:

- **SMS-te e terminuara ne rrjete te ndryshme jane pjese e tregjeve te vecante perkates;**
- **Llojet e ndryshme te terminimit te SMS-ve sipas origjines: nga rrjete celulare, rrjete fikse/ISP (PUSH SMS), nuk krijojne zevendesueshmeri te plote;**
 - ❖ Nuk ka zëvendësueshmeri te një SMS nga rrjeti celular, me SMS drejt një rrjeti fikse apo Internet;
 - ❖ SMS ne celular, ka zëvendësim te pjesshem me një SMS në një kuti postare te internetit (burimet origjinuese si: (Interneti, rrjetet fikse), nuk janë në zëvendësueshmeri te plote për SMS-te qe origjinohen nga rrjetet celulare);
 - ❖ SMS nuk mund te konsiderohet si nje zëvendësim i plote nga një telefonatë zëri;
 - ❖ SMS-te dhe thirrjet me ze ofrojne sherbime me perdorime te ndryshme;
 - ❖ Zevendesueshmeria e nje SMS (te shkruajtur) me nje mezazh zanor (mesazhi zanor nuk e zevendeson ne menyre te plote SMS e shkruajtur).
 - ❖ SMS nuk eshte ne zevendesueshmeri te plote, pavaresisht tendences ne rritje nga sherbime te tjera te mesazheve, si MMS etj, apo perdorim te aplikacioneve te

ndryshme per rrjete sociale (Facebook, Tweeter, WhatsApp etj), qe mundesojne sherbimet e telefonise se levizshme (per shkak se kanë nevojë për disa shërbime shtesë per plotesimin e ketyre kërkesave si: aparat telefoni fleksibel per sherbimin (me i kushtueshem); lidhje ne internet (tarife shtese per internetin etj);

- ❖ SMS ne tregun me pakice me thirrje telefonike, (duhen konsideruar si plotesuese, dhe jo si sherbime ne zevendesim te plote);

AKEP nuk konstaton te kete ndonje ndryshim me percaktimet e bera ne analize pararendese, per rrjedhoje mban te njejtin arsyetim te perdorur dhe te argumentuar ne analizen pararendese;

- Ne lidhje me faktin ne se bejne pjese ose jo ne te njejtin treg perkates;
- Ne aspektin e zevendesueshmerise se ketyre produkteve/sherbimeve ne anen e kerkeses;
- Ne aspektin e zevendesueshmerise se ketyre produkteve/sherbimeve ne anen e ofertes;

Keshtu qe AKEP ne kete dokument analize, gjykon te arsyeshme te sjell ne vemendje vetem konkluzionin final te arritur ne analize 2011, per te cilin mban te njejtin qendrim dhe konkretisht:

Konkluzioni final per zevendesueshmerine e sherbimit SMS ne tregun e pakices, nga ana e kerkeses eshte se:

Sherbimi SMS-se ne tregun e pakices, nuk ka sherbim te plote zevendesues ne te gjitha karakteriatikat e tij, pavaresisht nga burimi prej nga origjinohet SMS, nga një rrjet i telefonisë së lëvizshme, nga interneti, apo qoftë edhe nga rrjete fikse, duke e konvertuar SMS (tekst të shkruar) në nivel IP.

Konkluzioni final për zëvendësueshmërinë e sherbimit SMS ne anen e ofertuesit:

Nga pikepamja se kush e ofron shërbimin e SMS, mund të thuhet se nuk ka një zëvendësim nga ana e ofertes, pasi në të gjitha rastet pavarësisht burimit nga origjinohet një SMS, do të destinohej në nevojën e blerjes së shërbimit të terminimit për këtë SMS në rrjetet e operatoreve celular, që për nga vetë natyra e këtij shërbimi, nuk mund të jetë zëvendësues në rrjetet reciproke.

Përfundimisht ne lidhje me zëvendësueshmërinë e shërbimit të terminimit, në dy anët e saj, kërkesë - ofertë, në tregun e shumicës konkludohet që:

Sherbimi i terminimit për SMS, për shkak të pamundësisë teknike për një operator për të terminuar një SMS në një rrjet tjetër të telefonisë së lëvizshme, për të cilën nuk zoteron kartën SIM, nuk ka asnjë tjetër mundësi zëvendësimi te kërkesës në tregun me shumicë.

Ndaj duke i konsideruar si zoterues te plote cdo operator celular te rrjetit te tij, pavaresisht teknologjise mbi te cilen e ka ndertuar rrjetin e tij GSM, UMTS etj, domosdoshmerisht duhen ofruar sherbimet e interkoneksionit ndermejt ketyre rrjeteve, me qellim qe te mundesohen sherbimet e cituara me sipër ne tregun e pakices.

Terminimi i SMS-ve ne nje rrjet te caktuar celular i ofruar nga operator i ketij rrjeti nuk mund te ofrohet nga asnje operator rrjeti tjetër si dhe nuk mund te zevendesohet me terminimin e SMS-ve ne nje rrjet tjetër. Pra:

- *Terminimi i SMS-ve ne rrjete te ndryshme celulare jane pjese te tregjeve perkates te ndryshem.*

II. Dimensioni gjeografik i tregut të SMS-ve

Hapësira gjeografike në të cilën shtrihet shërbimi i rrjetit të telefonisë së levizshme (për të përdorur spektrin e frekuencave kombëtare), duhet konsideruar si një hapësirë gjeografike që mundesohet edhe shërbimi i ofrimit të SMS-se, për rrjedhojë konkludohet se dimensionimi i këtij tregu është kombëtar.

Ky konkluzion të mundëson që si hapësirë gjeografike të konsiderohet hapësira gjeografike e mbulimit me rrjet për secilin operator të telefonisë së levizshme.

Përfundim:

Tregu përkatës i terminimit të SMS-ve është një treg që identifikohet si treg i vecantë për secilin rrjet të telefonisë së levizshme:

- *Tregu me shumicë i terminimit të mesazheve SMS në rrjetin celular Albanian Mobile Communication;*
- *Tregu me shumicë i terminimit të mesazheve SMS ne rrjetin celular Vodafone Albania;*
- *Tregu me shumicë i terminimit te mesazheve SMS në rrjetin celular te Albtelecom Sh.a;*
- *Tregu me shumicë i terminimit të mesazheve SMS në rrjetin celular Plus Communications;*

III.3 APLIKIMI I TESTIT TË TRE KRITEREVE

Ne analizen pararendese, AKEP ka aplikuar testin e tre kriterëve dhe ka provuar që plotësoheshin të tre kriteret, duke e konsideruar tregun e terminimit të SMS-ve si një treg të pershtatshëm për t'u analizuar për FNT dhe nderhyrje ex-ante.

Kështu që edhe në këtë dokument analizë, AKEP para se të analizojë për FNT tregun me shumicë të terminimit të SMS-ve, ka për detyrim të aplikojë testin e tre kriterëve dhe të provojë që plotësohet ky test në të tre kriteret.

- *prezenca e barrierave të larta dhe jo-kalimtare të hyrjes;*
- *nje strukture tregu e cila nuk ka tendence për të shkuar në drejtimin të një konkurrence efektive brenda afatit kohor përkatës; dhe*
- *pamajftueshmeria e ligjit të konkurrences për të adresuar në mënyrë të pershtatshme deshtimin e tregut të marre në shqyrtim;*

Nëse nga kjo analizë e tre kriterëve të mesipërme arrihet në përfundimin se ky treg nuk plotëson një nga tre kriteret e referuara më sipër, atëherë AKEP nuk duhet të analizojë këtë treg për fuqi të ndjeshme, për rrjedhojë dhe nuk duhet të vendosë detyrime rregullatore në këtë treg.

Kriteri I-re:

- *tregu i terminimit te SMS-ve, ka prezence te barrierave te hyrjes dhe keto barriera jane jo-kalimtare.*

Ne lidhje me kriterin e I-re, AKEP nuk konstaton te kete asnje ndryshim nga percaktimet e bera ne analizen pararendese, rrjedhimisht mban te njejtin konkluzion edhe ne kete dokument analize duke ruajtur vleresimin se kriteri i I-re plotesohet, sepse shërbimet e terminimit janë input te pazevendesueshme të shitjes me pakicë, pavaresisht natyres se shërbimit te ofruar (thirrje apo SMS).

Natyra e barrierave strukturore per shërbimin e terminimit, ngelet e pandryshuar dhe ne nje perfundim te tille arrihet duke nënkuptuar se ekzistojnë barriera për hyrjen në tregun me shumicë te terminimit te SMS-ve për shkak të kushteve strukturore, pasi vetëm operatori zoterues i rrjetit është në gjendje për të përfunduar dorëzimin e SMS tek pajtimtari i rrjetit te tij, për çdo operator tjetër, për këtë arsye është e nevojshme për të blerë shërbimin e terminimit te SMS-se.

Pra ne te gjitha arsyetimet e perdorura (pershire arsyetimet ne analizen pararendese) eshte konkluduar se kriteri i parë është përmbushur.

Kriteri II:

- *Tregu i terminimit te SMS-ve, nuk ka tendencë për të shkuar në drejtimin e një konkurrence efektive brenda afatit kohor përkatës (minimalisht një periudhe 2 vjecare).*

Vleresimi per tendencen e konkurrences ne se eshte eficente apo thjesht ka nje zhvillim pozitiv, eshte e lidhur kryesisht me arsyet qe kane bere te mundur zhvillimet pozitive ne kete treg.

Duke vleresuar karakteristikat e vecanta te tregut te terminimit te SMS-ve (ne secilin rrjet te operatoreve celulare), si dhe referuar te gjitha praktikave rregullatore të cilat kanë kryer testin e tre kriterëve në tregun me shumicë te terminimit te SMS-ve, eshte arritur në përfundimin se mundesia qe te kete konkurrence efektive (me tarifa te orientuara drejt kosos eficente te ketij shërbimi), bazuar ne natyren e marredhenieve komerciale ndermjet operatoreve per shërbimin e terminimit te SMS-ve, favorizojne nje sjellje te perbashket te ketyre rrjeteve per te mos orientuar tarifen e ketij shërbimi drejt kosos ne nje periudhe afatmesem, duke qene te favorizuar nga kushtet strukturore.


Historiku i ecurise se tarifave te terminimit per shërbimin e SMS-ve ka ecur pozitivisht, kjo nuk ka ndodhur mbi baza komerciale, por si rezultat i nderhyrjeve rregullatore ne percaktimin e ketyre tarifave. Ne tregun shqiptar te terminimit te shërbimit te SMS-ve, aktualisht tarifa e terminimit ne te kater rrjetet celulare eshte 1.44 leke/SMS, por kjo ka ndodhur pasi ne shtator 2011 e ne vijim, sipas nje skedulimi kohor dhe percaktimit te tarifes se terminimit nga AKEP eshte levizur pozitivisht nga 3 leke/SMS ne 2 leke /SMS dhe aktualisht qe nga Shtator 2013 eshte 1.44 leke/SMS. Por kjo vlere eshte perseri shume larg kosos eficente te shërbimit te terminimit te SMS (te vleresuar sipas BU-LRAIC e cila eshte 0.58 leke/SMS) dhe akoma me larg “kosos se

paster” qe shkakton kete sherbim ne se do te llogaritej sipas LRAIC (te paster), apo vleresimeve te dhena nga BEREC per koston mesatare per nje grup vendesh te marra ne konsiderate.

Kostot e ofrimit te sherbimit eficient per SMS-se, demostrojne ne menyre te dukshme, nje sjellje bashkerenduese, apo ne heshtje te ofruesve te ketij sherbimi, e cila pengon stimujt e nevojshem per te patur nje konkurrence efektive ne kete sherbim, kundrejt te gjitha normave te arsyeshme te fitimit qe lejon ofrimi i ketij sherbimi.

Si pasoje e konsiderimit nga ana e operatoreve si nje input te rendesishem te te ardhurave te tyre, ne thelb kjo ka bere te konsiderohet i rendesishem per anen e tyre ekonomike, dhe te mos sherbeje si nxitje per konkurrence ne ofrimin e ketij sherbimi. Arsyet qe tarifat e terminimit per (sherbimet e terminimit ne rrjete te vecanta) te ndryshojne apo te shkojne ne koston eficente te tyre (perfshire tarifen e terminimit te SMS-ve), sa kohe qe modeli i pageses eshte “pala origjinuese e SMS-se, paguan”, ka pak ose aspak nxitje e brendshme ekonomike per operatorët për të vendosur normat e tyre të terminimit në një nivel "konkurrese" (niveli që mund të pritet, në qoftë se shërbimet e terminimit celular ishin subjekt i konkurrencës efektive), pasi nuk ka zëvendësues të vërtetë që mund të detyrojnë sjelljet e operatorëve celularë, per rrjedhoje ka pak ose aspak nxitje e brendshme ekonomike për operatorët e telefonisë celulare për të ofruar sherbime terminimi ne aspektin ekonomik dhe teknik (te sherbimeve te interkoneksionit).

Figure III.3.1 Tarifa e terminimit te SMS-ve per vendet ne rregullim dhe jo te rregulluara (kostoja mesatare e shprehur ne euro/cent)




Burimi: BEREC

Nje percaktim i tille eshte me se i sakte, pasi ne se do te krahasoheshin vendet qe kane nderhyre per rregullimin e tarifes se terminimit te SMS-ve, bazuar ne percaktimet e bera nga analizat e tregjeve te kryera si dhe vendet qe nuk kane nderhyre, vihet re qe edhe ne rastin e uljes se vullnetshme te tarifes se terminimit (qe gjithesesi numri i vendeve qe kane ulur ne menyre te vullnetshme tarifen e terminimit, eshte i vogel), perseri kjo tarife eshte shume larg koston eficente te ofrimit te sherbimit te terminimit te SMS-ve.

Ecuria e ndryshimit te tarifes se terminimit per sherbimin e SMS-ne, duke krahasuar vendet qe kane nderhyre nepermjet rregullimit si dhe vendeve qe nuk kane nderhyre nepermjet rregullimit, ilustruhet nepermjet figures se meposhtme:

Figure III.3.1 Ecuria e tarifave te terminimit te SMS-ve ne Europe



Burimi: BEREC

Perfundimisht ne lidhje me kriterin e dyte konkludohet se: tregu i terminimit te SMS-ve ne rrjetet celulare nuk ka tendence te shkojne drejt konkurrences efektive, rrjedhimisht qe kriteri i dyte plotesohet.

Kriteri III:

- pamjaftueshmerinë e ligjit të konkurrencës për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dështimin e tregut të marrë në shqyrtim

Duke konsideruar vleresimin e bere per dy kriteret e para, ku nder te tjera vihet re qe ka prezence te kushteve strukurore në tregun me shumicë për terminimin e SMS-ve, konstatimi i pare rezulton se:

Ka hapësira te mjaftueshme per nderhyrje ex-nate ne kete treg, kjo edhe duke konsideruar analogjine ne trajtimin e dy sherbimeve baze te telefonise se levizshme (thirrjet zanore dhe SMS-te) dhe perfundimin e pakontestushem mbi nevojën e nderhyrjeve ex-ante ne tregun e terminimit te thirrjeve ne nivelin e shumices.

Referuar edhe te gjitha praktikave rregullatore qe kane aplikuar testin e tre kriterëve per sherbimin e terminimit te SMS-ve, si dhe aplikimit te ketij testi ne analizen pararendese nga vete AKEP, eshte konkluduar qe ligji i konkurrencës nuk është i mjaftueshem per te adresuar ne menyre te pershtatshme dështimet e tregut te terminimit te SMS-ve, (pasi ky sherbim eshte nje sherbim interkoneksioni) dhe si i tille zgjidhje me efikase do te percaktonte nderhyrja ex-ante, edhe per vete faktin qe nderhyrjet e mundshme ne reference me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, ne te gjitha rastet do te kishin nje natyre me te kufizuar, dhe vetem ne rast se keto masa nuk rezultojne efektive, apo pengohen nga operatorët me FNT, atehere mund te zbatohen percaktimet e ligjit te konkurrences.

Keshtu qe ne lidhje me kriterin e trete, AKEP konstaton se plotesohet.

Bazuar ne vleresimin e bere pas aplikimit e testit te tre kritereve (kritere te cilat plotesohen), AKEP gjykon se tregu (tregjet) i terminimit të SMS-ve, plotësojne kriteret për të qënë treg përkatës i justifikueshem për ndërhyrje ex-ante, duke vleresuar se ky treg duhet të analizohet për fuqi te ndjeshme.

III.4 ANALIZA PËR FUQI TË NDJESHME NË TREG

Ne praktiken e ndjekur per kryerjen e analizes me fuqi te ndjeshme te tregut, AKEP eshte bazuar ne kriteret dhe percaktimet e bera ne nenin 33 te ligjit 9918, i ndryshuar. Por ne varesi te natyres se tregjeve te analizuara, AKEP nuk ka perjashtuar edhe kritere te tjera, qe fuqizojne argumentet e trajtuara (perfshire edhe praktikate e tjera rregullatore te ngjashme).

Ne kete dokument analize, ne lidhje me sherbimin e terminimit te SMS-ve , per vete natyren e ketij tregu te percaktuar qe ne perkufizimin e tij, i percaktuar si nje sherbim i natyres monopolistike, do te justifikonte nje perdorim me pak te detajuar te argumenteve te tjere, qe do te vertetonte se cdo operator celular ka FNT ne rrjetin individual te tij per sherbimin e terminimit te SMS-ve.

Faktoret e konsideruar edhe ne analizen pararendese si:

- **Pjeset e tregut;**
- **Konkurrenca e mundshme në tregun e terminimit të SMS-ve në rrjetet celulare;**
- **Fuqia kundervepruese e blesesve te terminimit te SMS-ve ne rrjetet celulare;**

jane faktore te cilet nuk kane ndryshuar per vete natyren e tregut dhe sherbimin e konsideruar me natyre “monopol”, ne secilin rrjet individual te operatoreve celulare, per te cilet AKEP nuk e gjykon te arsyeshme te ri-trajtoje perseri, duke qene se jane te njejtat rrethana dhe arsytetime te perdoruara edhe ne trajtimin e gjere te bere ne analizen pararendese per tregun perkates.

Ne lidhje me sherbimin e terminimit te SMS-ve, ne per secilin nga operatoret e telefonise se levizshme, ne rrjetet individuale te tyre, bazuar ne vleresimin e faktoreve te evidentuar me sipër, rezulton qe:

- 100% pjese tregu per secilin operator celular ne rrjetin e tij;
- barriera te natyres strukturore dhe mungese te fuqise kundervepruese te blesesve per sherbimin e terminimit te SMS-ve, per vete specifiken e sherbimit te terminimit (natyre monopolistike);
- efekt i rrjetit si rezultat i integritimit vertikal;
- mungese e konkurrences efektive ne potencialet e mundshme qe duhej te ofrohej ne rrethana, jashte nderhyrjes ex-ante;

Por per vete zhvillimet e ndodhura dhe tendencen per te perqendruar pajtimtare kryesisht ne grupe te mbyllura apo ngurtesimin e bazes se pajtimtareve brenda rrjetit, AKEP gjykon qe te trajtoje ne menyre me te diferencuar disa faktore te tjere, qe kane te bejne kryesisht me:

a) *Asimetrine e trafikut te zhvilluar (volumit te SMS-ve te shkemyera) ndermjet rrjeteve si marredhenie interkoneksioni ndermjet tyre dhe mundesite reale per shtremberime te konkurrences;*

Fenomeni i zhvillimit te trafikut te SMS-ve (kryesisht brenda rrjetit) ka te njejten analogji si me trafikun e thirrjeve ne telefonine e levizshme dhe eshte nje fenomen me shtrirje globale, pasi kryesisht kjo vjen nga numri i madh i ofertave si dhe nga pushteti i marketingut te operatoreve te telefonise se levizshme ne adrese te perdoruesve te ketyre sherbimeve. Nje gje e tille mundeson krijimin e asimetrise ndermjet trafikut te sherbimeve perkatese dhe qe shkembetet ndermjet rrjeteve celulare. Praktikisht ne kushtet kur operatoret kane madhesi te ndryshme te bazes se perdoruesve (pajtimtareve te tyre), eshte e pamundur qe te pretendohet per trafik te balancuar te sherbimeve te interkoneksionit. Por kjo asimetri e trafikut nuk eshte vetem per faktin qe rrjetet kane dimensione te ndryshme te bazes se pajtimtareve, por varet edhe nga nje grup faktoresh te tjere, qe kryesisht konsiderohen si politika te brendshme te zhvillimit te biznesit (marketingu agresiv ne kete drejtim, dhe perben nje fenomen global).

Ne se do te referoheshim ne evidentimin e trafikut te SMS-ve te terminuara ne rrjetet celulare (trafikun off-net te SMS-ve), dimensionet e rrjeteve celulare ne sherbimin e terminimit te SMS-ve ne rrjetet e tyre do te prezantoheshin sipas tabelës se meposhtme:

Tabela III.4.1 Pjeset e tregut ne % per terminimin e SMS-ve (off-net) 2013

Struktura e SMS-ve te terminuara (ne %)	AM C	VF	Albtelecom sh.a (EM)	Plus
2013	26	49	14	11
2012	25	52	13	9
2011	28	53	15	4

Vihet re se ne lidhje me pjeset e tregut per sherbimin e terminimit te SMS-ve (off-net), ka asimetri e cila vjen kryesisht nga dimensionet e bazes se pajtimtareve te rrjeteve te ndryshme. Por diferenca e asimetrise per trafikun e zhvilluar (terminimi i SMS-ve off-net) eshte me e vogel se asimetria e trafikut te thirrjeve te terminuara sipas te njejtes llogjike nga rrjetet celulare. Kjo shpjegohet edhe me faktin qe ne rastin e dergimit te SMS-ve, probabilitetit i “replikimit” te marresit te SMS-se me derguesin eshte me i madh se ne rastin e kryerjes se thirrjes telefonike. Kjo perben edhe arsyen e kryesore per dimensionet e asimetrise ne volumet e shkembimit te trafikut te SMS-ve (si sherbim interkoneksioni) ndermjet rrjeteve celulare.

Tendenca per te orientuar tarifat per sherbimet e interkoneksionit (kryesisht sherbimin e terminimit ne nivelin e shumices) drejt koston por edhe ne nje simetri ndermjet rrjeteve, jane konsideruar si tregues qe favorizojne konkurrencen efektive per sherbimet perkatese ne rrjetet celulare.

b) *Efektet e rrjetit tek sherbimi i terminimit te SMS-ve, paketat “Bundles” (brenda rrjetit dhe kryesisht ne grupet mbyllura);*

Klasifikimi i bere per sherbimet baze te telefonise se levizshme (on/net dhe off/net) vjen kryesisht nga klasifikimi i brendshem i bere nga vete operatoret per te identifikuar tipologjine e

sherbimit (thirrje dhe SMS). Dimensionet e bazes se pajtimtareve sipas rrjeteve, percaktojne edhe peshen e efekteve te rrjetit, pasi rrjetet e medha (baza e pajtimtareve) ka tendencen per te zhvilluar me shume trafik per sherbimet respektive. Ky efekt rritet akoma me shume ne kushtet e nje zgjerimi te madh te games se ofertave te ofruara nga te kater operatoret e rrjetit te telefonise se levizshme.

Tendenca globale per te ofruar gamen e sherbimeve qe mundeson nje rrjet (Thirrje, SMS dhe Internet) te grupuara si nje pakete e vetme (bundles), dhe kjo tendence eshte e shtrire ne menyre te ngjashme ne te kater rrjetet e telefonise se levizshme, krijojne ne menyre te natyrshme edhe efekte me te ndjeshme nga rrjetet e medha. Duke qene se ofrohen si nje grup sherbimesh te paketuara, shkalla e zevendesueshmerise se tyre mund te rritet akoma me shume se ne rastin kur keto sherbime mund te ishin individualisht jashte paketes, pasi pervec anes funksionale qe do te merrej ne konsiderate ne kete zevendesueshmeri, edhe tarifimi i ketij sherbimi eshte konsideruar si i tere ne portofolin e paketes.

Zevendesueshmeria e konsideruar ne anen e kerkeses, ka disa karakteristika qe kushtezojne pajtimtarin (perdoruesin) te ndryshoje rrjet, apo te rrije ne rrjetin egzistues. Kjo kryesisht ka te beje me kosto shtese ne ndryshim rrjeti, apo humbje te kontakteve egzituese. Instrumenti i portabilitetit te numrit, (funksional aktualisht ne Shqiperi) e ben me te mundur edhe zevendesueshmerine ne anen e kerkeses sipas arsytimit te perdorur me siper.

Por ajo qe vlen te theksohet ne kete rast eshte, se efekti i rrjetit ka nje peshe te rendesishme edhe ne asimetrine e trafikut te zhvilluar per sherbimet e interkoneksionit (ne kete rast edhe sherbimi i terminimit te SMS-ve) duke u bere akoma me i stimuluar nga paketat “bundles”, te ofruara ne menyre analoge nga te gjitha operatoret e rrjetit te telefonise se levizshme, pjese e arsytimeve te perdorura ne kete dokument analize.

c) Efektet e mundshme te masave rregullatore ne nivelin shumices dhe transferimi i tyre ne tregjet e pakices;

Parimisht efektet e masave rregullatore te vendosura ne tregjet me shumice (perfshire tregun e terminimit te SMS-ve), konsiderohen si instrumentet e duhura dhe me efikase per te rritur dhe zhvilluar konkurrencen efektive ne tregjet e brendshme dhe ne teresine e tyre percjellin “ne zinxhir” efektet ne tregjet e pakices, prej te cilave finalizohen direkt perfitimet e perdoruesve fundor.

Nder masat rregullatore prej te cilave mund te gjykohet efekti i transferimit te uljes se tarifave te SMS-ve nga niveli i shumices ne tregjet e nivelit te pakices per sherbimin perkates, eshte “mosdiskriminimi” si dhe “kontrolli i tarifes se terminimit”.

Por prezenca e nje numri te madh te paketave ofertuese (me plane tarifore te ndryshme) veshitoreson matjen e efektit te drejteperdrejte, ne se do te krahasoheshin keto ndryshime kryesisht ne paketat standarte ne treg, ose ne paketat ofertuese te limituara (duke gjykuar tarifen per sherbimin e SMS-se, pas perfundimit te ofertes).

I. Përvoja rregullatore në vendet e rajonit dhe të BE-së

Ne analizen pararendese eshte referuar pervoja rregullatore ne vendet e BE-se dhe te rajonit ne lidhje me rregullimin ose mungesen e rregullimit te sherbimit te terminimit te SMS-ve, ne rrjetet celulare.

Pavaresisht se ka nje numer te vogel te vendeve qe kane analizuar dhe nderhyre ne menyre ex-ante ne tregun e terminimit te SMS-ve, ne asnje nga opinionet dhe rekomandimet e BEREC dhe KE-se, nuk perjashtohet mundesia e nderhyrjes rregullatore nepermjet procesit te analizave te tregjeve dhe rrethanave kombetare specifike.


Nje gje e tille vihet re edhe ne “*EXPLANATORY NOTE*”, te rishikuar, me qellim konsiderimin e mundesive per te nxjerre ndonje rekomandim te ri per tregje te pershatshme per t’u konsideruar per rregullim.

Keshtu ne lidhje me tregun e terminimit te SMS-ve, KE vazhdon te qendroje ne te njejtin opinion se ne varesi te rrethanave kombetare, per te percaktuar nese terminimi i SMS-ve ka te njejtat probleme te fuqise ne treg si terminimi i thirrjeve, eshte ne gjykimin e rregullatorit te konsideroje percaktimin e nje tregu shtese te vecante per SMS-te.

Keshtu qe praktika e vendeve te cilat kane nderhyre ne tregun e terminimit te SMS-ve, nepermjet procesit te analizave te tregut, duke aplikuar testin e tre kritereve, kane provuar se problemet e shfaqura ne tregjet e terminimit te SMS-ve jane analoge me tregjet e terminimit te thirrjeve. Keshtu qe keto praktika te ndjekura nga Franca, Danimarka, Polonia, kane mundesuar edhe krahasueshmerine ndermjet vendeve te cilat kane nderhyre ne menyre ex-ante si dhe vendeve te cilat nuk kane nderhyre (duke i rregulluar kryesisht nepermjet marreveshjeve komerciale te vete operatoreve ne treg), duke arritur ne konkluzionin se ne rastin e dyte edhe kur ka patur ulje te tarifave te terminimit te SMS-ve, keto ulje kane qene shume larg tendences per te orientuar tarifat e terminimit drejt kostos (perفشire edhe tarifen e terminimit te SMS-ve).


BEREC, ka bere vleresime te tarifave te terminimit te SMS-ve, dhe ka publikuar nje “snapshot report” benchmark per tarifat e terminimit te SMS –ve, per nje numer te shteteve anetare te BE-se, duke perfshire edhe disa vende te tjera si: Zvicra, Kroacia, Islanda, Maqedonia Norvegjia, Serbia, dhe Turqia. Ne kete vleresim BEREC eshte referuar ne tarifat me te uleta te terminimit te SMS-ve, duke referuar edhe tarifen mesatare per terminimin e SMS-ve.

Figura IV.1 Tarifa e terminimit te SMS-ve per shtete te ndryshme (2013)



Burimi: BEREC BoR (13) 178 rev2, Nentor 2013

Figura IV.2 Tarifa e terminimit te SMS-ve (sipas rregullimit)



II. Përfundime mbi fuqine e ndjeshme ne tregun e analizuar

AKEP, ne kete raund te analizes, ka konsideruar here pas here edhe konkluzionet e analizes pararendese, pasi per vete specifiken qe kane tregjet e terminimit (thirrje v SMS), problemet qe pengojne zhvillimin e konkurrences efektive kane ngjashmeri te plote, duke konsideruar qe ne rrethana te tjera (jashte nderhyrjeve ex-ante) të gjithë faktorët që mund të inkurajojnë zvoglimin e kesaj tarife, do të jenë në disfavor të zhvillimit te konkurrences efektive per rrjedhoje edhe te perfitimeve te konsumatorit, apo përdoruesit final të SMS-së.

Keshtu, në secilin nga rrjetet e operatoreve të telefonisë së lëvizshme, do të rezultojë fuqi e ndjeshme në treg nga secili nga operatorët e rrjetit të telefonisë së levizshme.

Në analizën e faktorëve të marrë në konsideratë për fuqinë e ndjeshme në tregjet perkatës, rezulton se ngelen te njejtet faktore te konsideruar edhe ne analizen pararendese, dhe konkretisht:

Secili prej operatoreve AMC, Vodafone Albania, Albtelecom Sh.a (E.M) dhe Plus Communication , ne rrjetet individuale te tyre kane:

- 100% pjese ne rrjetin e tij;
- barriera te natyres strukturore;
- mungese te fuqise kundervepruese te blesesve per sherbimin e terminimit te SMS-ve, per vete specifiken e sherbimit te terminimit (natyre monopolistike);
- prezence te efektit te rrjetit nga integrimi vertikal;
- mungese e konkurrences efektive ne potencialet e mundshme qe duhej te ofrohej ne rrethana, jashte nderhyrjes ex-ante;

Per vete natyren e ketyre tregjeve (monopolistike) dhe analogjine me tregjet e terminimit te thirrjeve, kriteret e marra ne shqyrtim nuk pritet te ndryshojne ne afatmesem, ne menyre qe te eliminojne aftesine ndikuese te operatoreve ne tregjet perkates te terminimit te SMS-ve, apo edhe te mbajne fazen aktuale te zhvillimit te konkurrences ne kete treg.

Keshtu qe, AKEP gjykon se:

Operatorët Vodafone Albania, Albanian Mobile Communication , Albtelecom Sh.a (E.M) dhe Plus Communications përmbushin kriteret për fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse të terminimit të SMS-ve në rrjetet e tyre celulare.

III.IV. MASAT RREGULLUESE NE TREGJET ME SHUMICE TE TERMINIMIT TE SMS-VE

Pas perfundimit te keshillimit publik te dokumentit te analizes se tregut per terminimin e SMS-ve, trajtimit te komenteve te paleve te interesuara mbi dokumentin e cituar, referuar edhe propozimit te bere nga AKEP ne lidhje me masat rregullatore, AKEP vlereson te drejte vijimesine e masave te vendosura ne analizen pararendese:

Ne reference me parashikimet e Ligjit 9918 i ndryshuar, me qellim zgjidhjen e problemeve te identifikuara AKEP percakton masat rregullatore si ne vijim:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit(neni 39);
2. Detyrimi i transparencës (neni 40);
3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit(neni 42);
4. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (neni 45);

Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)

Ky detyrim shërben për te mos-lejuar diskriminim midis operatoreve perfitues si edhe diskriminim e tyre ndaj filialeve apo partnereve të vet.

Detyrimi për dhënien e Garancive apo marreveshjes së Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement-SLA) si dhe publikimin e Treguesve Kryesore të Performancës (Key Performance Indicators -KPI), të pershkruar me sipër.

Per sa i perket publikimit te ofertes reference per terminimin e SMS-ve, bazuar edhe ne pervojen ne vendet qe kane vendosur detyrime per terminimin e SMS-ve, AKEP vlereson se nuk eshte e nevojshme publikimi i RIO per SMS nga operatoret celulare.

Detyrimi i transparencës (Neni 40)

Ne lidhje me kete detyrim, operatoret celulare do te duhet te bejne publike tarifat e terminimit te SMS-ve ne rrjetet e tyre, sipas fazave kohore dhe vlerave te percaktuara ne vendimarrjen e ketij dokumenti per sipermarresin perkates.

3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)

AKEP vlereson se për FNT për terminimin e mesazheve SMS në rrjetet celulare, janë të nevojshme masat:

- a) t'u ofrojë palëve të treta akses në elemente të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve;
- c) të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;
- ç) të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- dh) të ofrojë bashkëvendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, përfshirë ndërtesat, tubacionet kabllore ose shtyllat, kullat;
- ë) të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (*software*), të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve;
- f) të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit.

g) të ofrojë akses në shërbimet shoqëruese

Sic është sqaruar në perkufizimin e tregut, terminimi i SMS-ve përfshin vetëm terminimin e SMS-ve të origjinuara në rrjetet celulare, dhe në këtë sens secili operator celular me FNT për terminimin e SMS-ve në rrjetin e tij ka detyrimin t'u ofrojë operatorëve të tjerë celulare akses për terminimin e SMS-ve të origjinuara në rrjetet e tyre.

4. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe orientim në kosto

AKEP ka vlerësuar të nevojshme të vazhdojë rregullimin e tarifave të terminimit të SMS-ve duke përcaktuar vlerën maksimale të tyre sipas periudhave kohore respektive të vendosura në tabele. Nga tre alternativat e dhëna në dokumentin e keshillimit publik është zgjedhur alternativa e dytë, por duke realizuar vetëm një reduktim në vend të dy reduktimeve të propozuara. Sipas kësaj alternative tarifa e terminimit të SMS-ve do të reduktohet nga 1.44 lek/SMS që është aktualisht në 1.00 lek/SMS, për të katër operatorët celulare. Afati i fillimit të aplikimit të tarifës së re të terminimit të SMS-ve do të jetë data 1.04.2014, e njëjtte me datën e fillimit të reduktimit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare të përcaktuara nga AKEP në dokumentin dhe vendimetetë përkatëse për *“Rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”*.

TABELA III.5 : TARI FAT MAKSIMALE TË TERMINIMIT TË SMS-VE NË RRJETET CELULARE

	Aktuale - 31 Mars 2014	1 Prill 2014- në një vendim tjetër të AKEP
Vodafone		
AMC	1.44	1.00
Albtelecom (EM)		
Plus Communication		

Tarifat në Lek/SMS pa TVSH

AKEP gjykon se kjo është alternative më e mirë bazuar në disa faktore:

- Terminimi i SMS-ve është një shërbim i rregulluar (FNT dhe tarife nën rregullim) vetëm në katër vende në Evropë: Danimarkë, Francë, Poloni dhe Turqi.
- Tarifa e terminimit në katër vendet në rregullim është 0.18 eurocent/SMS në Turqi dhe 1.00-1.19 eurocent në tre vendet e tjera. Tarifa mesatare e terminimit të SMS-ve në këto katër vende është 0.86 eurocent/SMS apo 1.20 lek/SMS
- Në vendet që kanë tarife të terminimit nën 1.00 eurocent/SMS, janë Lituania, Qipro dhe Turqia e cituar edhe më sipër. Tarifa mesatare e terminimit në katër vendet që kanë nën-rregullim terminimin e SMS-ve, dhe dy vendet me tarife nën 1.00 eurocent, tarifa mesatare është 0.82 eurocent/SMS, apo 1.15 lek/SMS.
- Tarifa mesatare e ponderuar e terminimit të SMS-ve në 34 vendet e publikuara nga BEREC në Korrik 2013 është 3.46 lek/SMS që është shumë më e lartë se tarifa mesatare në vendet që kanë nën-rregullim SMS.
- Niveli 1.00 lek/SMS që do të aplikohet përben një reduktim prej 31% nga niveli aktual, dhe në vlerë absolute (0.71 eurocent) është tarifa e tretë më e ulët në Evropë.

Vlerësohet se kjo masë rregullatore do të mundësojë një mjedis më të ekuilibruar ndërmjet operatorëve duke krijuar stimuj më të rritur për ofrim të tarifash më të lira në nivel më pakicë, sidomos për tarifat standarte/nominale (jo të përfshira në bundles) për SMS jashtë rrjetit (off-net).

ANEKS 1. KOMENTET NE KESHILLIM PUBLIK DHE QENDRIMI I AKEP

Ne dokumentin per keshillim publik, AKEP kishte hartuar disa pyetje rreth te cilave kerkonte komente nga palet e interesuara, duke mos u kufizuar te drejten per t'u shprehur edhe jashte ketyre pyetjeve.

Ne perfundim te fazes se keshillimit per dokumentin e analizes, ne AKEP jane depozituar komente nga operatoret: Albtelecom Sh.a, Albanian Mobile Communication, Plus Communications dhe Vodafone Albania.

AKEP, falenderon operatoret e cituar me siper per perfshirjen me komentet e tyre per dokumentin e keshilluar.

Duke qene se nje pjese e komenteve te derguara jane voluminoze dhe reflektohet e njejta perseritje e argumenteve te perdorura ne dokumentin e analizes (arsyetime dhe grafike te perseritur te shkeputur nga dokumenti i analizes dhe riperdoren ne kendveshtrimin e operatorit per te argumentuar), AKEP gjykon te mjaftueshme te publikoje argumentet qe sjellin kundershiti ndaj dokumentit te analizes (apo pjese te vecanta te saj), duke reduktuar publikimin e pjeseve voluminoze, apo sintezave te pergjithshme, por ne te gjitha rastet duke ruajtur thelbin e komentit si ne rastin e dakortesise me qendrimet dhe konkluzionet e AKEP edhe ne rastin e kundershitimeve apo argumenteve ilustruese (te permbledhura) qe mbeshtesin kundershitimet sipas rastit.

Per cdo te interesuar, komentet e plota jane publikuar te shkeputura nga dokumenti i analizes.

Ndaj per orientim te lexuesit, ne vijim do te gjeni nje renditje te tille:

- pyetjen e hartuar nga AKEP ne keshillim publik;
- komentet/pergjigjet e secilit operator mbi kete pyetje, si dhe
- qendrimin e mbajtur nga AKEP per komentet perkatese

1. Cili është opinioni juaj në lidhje me përfundimet e AKEP për tregun me pakicë dhe tarifat e mesazheve SMS?

Pergjigje e Albtelecom Sh.a:

Në përfundimet e AKEP për tregun me pakicë të SMS në Shqipëri rezulton se tarifa për SMS standarde është e pa orientuar në kosto, është më e lartë se tarifa standarde e aplikuar në vitin 2011 dhe synon ngurtësimin e pajtimtarëve në grupe të mbyllura. Gjithashtu, ka një diferencë të madhe mes kësaj tarife dhe tarifës për SMS të ofruara në paketat tarifore jo standard të cilat janë dukshëm nën kosto, duke përbërë kështu diskriminim në ofrimin e të njëjtit shërbim me tarifa të ndryshme, si dhe duke moszbatuar detyrimin ligjor të orientimit në kosto të tarifave.

Albtelecom gjykon se përfundimet e mësipërme të AKEP në lidhje me këtë treg dëshmojnë për mungesën e konkurrencës efektive dhe ekzistencën e praktikave antikonkurruese, të cilat jo vetëm dëmtojnë operatorët me pjesë të ulët tregu duke mos i lejuar ata të rritin bazën e tyre të pajtimtarëve, por zvogëlojnë ndjeshëm edhe mundësitë reale për fitimin e mundshëm të konsumatorit në lidhje me këtë shërbim.

Pergjigje e AMC:

AMC mendon se përfundimet e AKEP për tregun me pakicë për një nivel konkurrues që shfaq ende probleme nuk janë të sakta, pasi nuk pasqyrojnë situatën reale të tregut me pakicë të SMS-ve dhe nivelin e lartë të konkurrencës që nga analiza e fundit e tregut retail të SMS-ve në vitin 2011.

Situata aktuale konkurruese në tregun me pakicë të SMS-ve është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me atë të periudhës deri në vitin 2011 kur është kryer analiza e parë e këtij tregu, si për shkak të rritjes së games së ofertave dhe paketave tarifore perkatese për perdoruesit, me cmime të arsyeshme dhe të perballueshme për kategoritë e ndryshme të perdoruesve (familjare, individuale, biznese, etj), si për SMS brenda rrjetit dhe për kategoritë e tjera të SMS-ve (jashtë rrjetit, për

pajtimtaret pre paid ose me kontrate), te cilat i jane derguar ne menyre periodike AKEP, duke bere qe perdoruesit te kene me shume mundesi perfitimi nga zgjedhja midis ketyre ofertave.

Rritja e konkurrences ne nivelin retail eshte rritur ndjeshem qe nga analiza e fundit ne tregun e SMS-ve per 2011, duke plotesuar gjithnje e me shume nevojat dhe esigjencat e kategorive te ndryshme te perdoruesve, nepermjet ofertave dhe paketave te shumellojshme tarifore me cmime te leverdisshme te SMS-ve dhe te perballueshme per abonentet.

Tarifat me pakice per SMS-te te ofruara nga AMC jane mese te krahasueshme me tarifat mesatare standart te vendeve te rajonit (South East Europe), dhe te vendeve te tjera te BE-se, si pasoje e politikave tarifore te orientuara drejt nevojave dhe mundesive financiare te abonenteve dhe nje faktor i rendesishem ne kete drejtim ka luajtur dhe numri i larte i operatoreve ne treg me politikat e ndjekura prej tyre, ne raport me dimensionin e vogel te popullsise ne vendin tone.

Perfundimet e evidentuara nga AKEP-i per nivelin retail nuk reflektojne ne kete menyre situaten reale te tregut me pakice te SMS-vet, pasi zhvillimet ne te tregojne se niveli i konkurrences eshte i plote dhe efektiv midis operatoreve, si ne terma te tarifave te ofruara nga operatorët, apo te numrit ne rritje te ketij sherbimi si pasoje e games se gjere te planeve tarifore dhe perfitimeve te shumta qe kane marre dhe vazhdojne te marrin abonentet, cka perputhet dhe me opinionin tone ne lidhje me kete pike, e theksuar kjo akoma me tej dhe me implementimin e dy faktoreve te tjere qe kane luajtur nje rol teper te rendesishem ne rritjen dhe realizimin e nje konkurrence efektive: portabiliteti i numrit qe nga viti 2011 dhe rritja e numrit te operatoreve qe ofrojne sherbimet. Kjo rrit me teper mundesite e perfitimeve per abonentet ne tregun me pakice te SMS-ve

Pergjigje e Plus:

PLUS mbështet përfundimet e AKEP për sa i përket përmbushjes së kriterëve të operatorëve për fuqi të ndjeshme në treg në tregjet përkatëse të terminimit të SMS-ve në rrjetet e tyre celulare. Dëshirojmë të theksojmë veçorinë e PLUS në raport me operatorët e tjerë duke qenë se PLUS nuk bën pjesë në asnjë grup ndërkombëtar shoqërisht. Gjithashtu, PLUS është një shoqëri me kapital tërësisht shtiptar.

Pergjigje e VF:

Vleresimi i konkurrences ne tregun perkates, shitja brenda paketes dhe larmia ne rritje e produkteve alternative zevendesuese te SMS thekson pasaktesine dhe panevojshmerine e analizes dhe rregullimit ex-ante te propozuar per kete treg

1. Vodafone Albania shprehet se kur behet nje analize per kete lloj sherbimi, duhet konstatuar qartesisht se Tregu perkates eshte *tregu i pergjithshem i telefonise se levizshme me pakice* qe perfshin te gjithë sherbimet e telefonise se levizshme (*si p.sh.* thirrje zanore, SMS, MMS, akses ne Internet) ofruar per konsumatorët me parapagese dhe me kontrate ne Shqiperi. Ky perkufizim i tregut eshte ne perputhje me perkufizimin e tregut te perfshire ne Shenimet Shpjeguese qe shoqerojne Rekomandimet e Komisionit Europian mbi tregun perkates te produkteve dhe sherbimeve ne sektorin e komunikimeve elektronike te parashikuara per rregullim *ex-ante*,³ nje sere precedentesh te Komisionit dhe precedente te ndryshem ne vendet e BE.
2. Ne keto kushte, perkufizimi i tregut duhet te reflektohet ne menyren se si AKEP ben vleresimin e konkurrences ne treg. Eshte e pakuptimeteqë tregu perkates te perfshijete gjithë sherbimet e levizshme, dhe nga ana tjetër analiza te zhvillohet ne segmente me te ngushte te tij (vetem sherbimi SMS). Sherbimet individuale ofrohen si pjese e nje pakete, jane plotesues te njeri tjetrit dhe deri diku jane produkte te zevendesueshem nga ana e kerkeses, ndaj duhen konsideruar si produkte te te njejtë treg pakice dhe analizuar si te tille, persa kohe qe:1) nuk ka kerkese me vete per secilin prej produkteve te perfshira ne pakete,2) pajtimtaret i konsumojne si nje pakete e tere dhe 3) ofrohen si nje pakete e tere. Pajtimtaret e perdorin aparatën celular per qellime te ndryshme, si psh per thirrje zanore apo dergim SMS, akses ne internet dhe sherbimet perkatese njekohesisht,dhe nuk perdorin nje

³Dokumentet Shoqeruese te Rekomandimeve te Komisionit mbi tregun perkates te produkteve dhe sherbimeve brenda sektorit te komunikimeve elektronike te predispozuara per rregullim ex-ante ne perputhje me Direktiven 2002/21/EC te Parlamentit dhe Keshillit Europian mbi strukturen e perbashket rregullatore per komunikimet elektronike, rrjeteve dhe sherbimeve (botimi i dyte), C(2007) 5406 rev 1, SEC(2007) 1483 final.

sherbim te vetem te percaktuar (sic do te ishte vetem SMS), por teresine e sherbimeve brenda paketes. Prandaj dhe pajtimtaret blejne (dhe u ofrohet) nje pakete e integruar apo nje 'njesi' sherbimesh nga nje operator i vetem,ku perfshihen thirrje dhe SMS ne nivel rrjeti, kombetar dhe nderkombetar si dhe akses ne internet e sherbimet perkatese.

3. Vodafone Albania konsideron se perfundimet fillestare ne Analizen e Tregut 2013 mbi sherbimin e SMS-ve te ofruar ne nivel pakice ne Shqiperi japin nje tablo jo te sakte te realitetit te konkurrences efektive. Si te tilla ato jane te papershtatshme per te perkufizuar e rregulluar tregun e terminimit te SMS-ve ne Shqiperi.

- Praktikate e diferencimit te cmimeve brenda rrjetit jane pro-konkurrese, kane sjelle perfitime per konsumatorin, nuk jane ne shkelje te ligjit dhe njihen e aplikohen nderkombetarisht;
- Konsumi i sherbimeve ka ardhur ne rritje ndersa te ardhurat e operatoreve kane pesuar rnie te vazhdueshme;

Qendrimi AKEP:

Komentet e derguara nga Altelecom dhe Plus shprehin dakortesine me percaktimet e bera nga AKEP ne analizen per tregun me pakice, ku Altelecom argumenton se arsyeja kryesore e mbajtjes per njeh kohsh shumsh tsh gjatsh tsh pozites dominuese ne treg (ne pjese tregu per sherbimin e SMS-ve nga VF) si dhe ulja e pjesesh tsh tregut tsh operatoresh tsh tjeresh, qendron ne aplikimin nga ana e Vodafone Albania tsh praktikave antikonkurrese tsh aplikimit tsh njeh tarife jashtsh rrjetit disa heresh mesh tsh lartsh se tarifat brenda rrjetit.

Por pavaresisht menyres se arsyetimit te bere nga Altelecom ne komentet e sjella nga AMC dhe VF (edhe pse voluminoze) ne teresine e tyre sjellin ilustrime per te provuar zhvillimin e konkurrences pozitive ne tregun me pakice te SMS-ve (gje te cilene AKEP e ka shprehur qartesisht ne dokumentin e keshilluar), duke mos e mohuar kete fakt. Kjo eshte detajuar ne menyre te qarte, pasi AKEP nder te tjera, pas analizes se bere referon nje permbledhje per tregun me pakice te sherbimit te SMS-ve, duke evidentuar se ne tregun e pakices ka zhvillim pozitiv te konkurrences, por akoma vazhdon te kete probleme qe deformatojne konkurrencen efektive, probleme te cilat zvoglojne mundesite reale per perfitimin e mundshem te konsumatorit ne lidhje me kete sherbim.

Nje konstatim i tille, nuk perjashton argumentet e sjella nga AMC dhe VF, pasi ne tersine e tyre argumentet e sjella gjenden te trajtuar ne dokumentin e analizes. Perpjekja per te pare argumentet e trajtuara ne kendveshtrime te ndryshme eshte e mirekuptuar, pasi AKEP synon perdorimin e instrumenteve te duhur ligjor dhe rregullator per te maksimizuar perfitimin e perdoruesve te sherbimeve te komunikimeve elektronike (ne rastin konkret per sherbimin e SMS-ve), por ne te gjitha rastet duke e orientuar tregun perkates drejt konkurrences efektive, ndersa kendveshtrimi i ofruesve te ketyre sherbimeve eshte maksimizimi i te ardhurave te tyre. Fakti qe ka zhvillime pozitive ne konkurrence, nuk do te thote qe eshte arritur konkurrenca e plote efektive.

AKEP, ne mbeshtetje te ketij arsjetimi, ka evidentuar qe ne tregun e pakices ka nje numer te madh te ofertave (plane tarifore te ndryshme), te cilat ne aspektin e perzgjedhjes, shumica e tyre percjellin nje konfuzion te madh per pajtimtaret, duke mos garantuar se zgjedhja e bere prej tyre eshte ajo e duhura ne raport me konsumin e duhur per pajtimtarin.

Eshte konsideruar i rendesishem fakti qe edhe pse ne tregun e pakices ka zhvillim pozitiv te konkurrences ne sherbimin e SMS-ve, konsiderohet qe shperndarja e perfitimit te mundshem per pajtimtaret nuk eshte e drejte, duke evidentuar diskriminim ndermjet grupeve te ndryshme ne aspektin e perfitimit per te njejtin sherbim te ofruar, pasi per paketat standarte te rrjeteve celulare tarifat per SMS standarte eshte e pajustificueshme ne raport me koston reale te SMS-se, cila do qofte arsyeja qe shtyn operatorin per te mbajtur te lidhur (te ngurtesuar) bazen e pajtimtareve ne rrjetet e tyre, kjo perben nje element te mjaftueshem per t'u konsideruar si pengese per konkurrence efektive ne dimensionet e plota te saj.

"Efekti i rrjetit", i konsideruar edhe ne kete dokument analize, nuk mund te mos shtrihe efektet e tij edhe ne tregun e pakices per sherbimet perkatese, perfshire edhe sherbimin e SMS-ve, pasi arsjetimi se ka oferta te mjaftueshme ne tregun e pakices, duhet vleresuar edhe ne kendveshtrimin e jetegjatesise se ketyre ofertave ne kushtet kur pjesen me te madhe te ketij tregu per sherbimin e SMS-ve (ne perqindje mbi 90%) e zene vetem dy operatorin VF dhe AMC (ku VF ka aktualisht mbi 70%). Arsyetimi i sjell

nga VF se perdorimi i sherbimit SMS ka ardhur gjithnje ne rritje dhe te ardhurat tregojne ulje te vazhdueshme, duke ilustruar se eshte teresisht e pajustificueshme qe te kerkohet nje rregullim i metejshem i tregut te shumices pasi faktet tregojne per nje konkurrence te shtuar dukshem, ne favor te cmimeve te ulta, perdorimit te shtuar dhe perfitimit te konsumatorit ne nivel pakice, duhet pare edhe ne aspektin qe sjell politika e tarifimit “grabitqar” (sidomos nga rrjetet e medha), ne konkurrencen afatgjate te ofertuesve te ketij sherbimi ne treg. Nje analogji e tille eshte edhe per sherbimet e tjera (pjese perberese ne tregun e pakices per sherbimet celulare).

Rrjedhimisht pas shqyrtimit te komenteve te sjella nga palet e interesuara mbi konkluzionet e AKEP per tregun me pakice per sherbimin e SMS-ve, e gjykon si nje qendrim te drejte i cili evidenton qartesisht indikatorët pozitiv te konkurrences ne kete treg, por ne te njejten kohe konsideron edhe faktore te cilet pengojne konkurrencen e plote efektive ne kete treg.

2. A mendoni se terminimi i SMS-ve në secilin rrjet celular përbën treg përkatës të veçantë?

Pergjigje e Altelecom Sh.a:

Siç është trajtuar edhe më pare, Altelecom mendon se terminimi i SMS-ve në secilin rrjet celular përbën treg përkatës të veçantë pasi çdo operator për terminimin e një SMS-je të pajtimtarëve të vet, nuk ka mundësi tjetër përveçse të blejë terminim te operatori drejt të cilit dërgohen SMS-të pra, rrjedhimisht, secili rrjet celular mundëson krijimin e tregut të terminimit në rrjetin e tij.

Pergjigje e AMC:

Terminimi i SMS-ve bazohet ne sherbimet ne formen e tekstit te shkurter midis operatoreve celulare, brenda dhe jashte rrjetit, duke luajtur nje rol komplementar por jo zevendesues ne lidhje me terminimin e thirrjeve. Te dyja sherbimet e terminimit (te thirrjeve zanore dhe SMS-ve) jane te lidhura ngushte me interkonektimin e rrjeteve midis operatoreve, dhe bejne te mundur komunikimin ne distance pavaresisht shpejtesise ne kohe ne realizimin e tyre. Por ka dy ndryshime te dukshme midis terminimit zanor dhe atij per SMS-te:

- Trafiku i SMS-ve behet vetem midis dy rrjeteve celulare dhe nuk evidentohet aspekti I zevendesueshmerise midis sherbimeve fiks dhe mobile tek operatorët e integruar (qe ofrojne te dyja sherbimet fiks dhe mobile), e cila redukton nivelin e asimetrisë ndermjet lojtareve ne treg;
- Trafiku i SMS-ve eshte me I balancuar se trafiku I thirrjeve zanore, pasi shpesh nje SMS pergjigjet me nje SMS tjetër. Eshte kjo nje arsye se pse tarifate e terminimit te SMS-ve ne ato vende ku aplikohet rregullimi i terminimit te SMS-ve, eshte reciprok.

Per shkak te shkalles me te madhe te simetrisë ne terminimin e SMS-ve midis operatoreve te ndryshem, dhe fuqia kundervepruese e tyre eshte me e balancuar. Dy aspektet e mesiperme bejne te mundur qe aplikimi i testit te tre kriterëve te mos plotesohet ne lidhje me terminimin e SMS-ve, sidomos ne lidhje me kriterin e dyte te testit, per shkak te zevendesueshmerise se SMS-ve nga sherbimet e tjera alternative te mesazhimit te castit bazuar ne internet (viber, whatsapp, mesazhimi ne rrjetet sociale, etj).

Nga kendveshtrimi i sherbimit, abonentet kane disa menyra per te marre dhe derguar mesazhe ne forme teksti (psh:, MMS, SMS, email, IM) ne rrjetet mobile. Keshtu qe vihet re nje zevendesim i qarte i ketyre sherbimeve cka sugjeron qe keto produkte te jene pjese e te njejtit treg

Gjithashtu, dhe Komisioni European nuk ka mbajtur nje qendrim te qarte ne lidhje me kete ceshtje (sic eshte evidentuar dhe ne dy rekomandimet perkatese te 2003 dhe 2007 per listen e tregjeve nen rregullim), duke mos u prononcuar ne evidentimin e tregut te terminimit te SMS-ve si nje treg me vete. Eshte pikerisht kjo arsyeja pse ky treg nuk perben nje treg specifik me vete por eshte pare me teper si treg i pershire ne tregjet e terminimit me shumice te thirrjeve zanore.

Pergjigje e Plus:

Tregu i terminimit të SMS-ve në secilin prej rrjeteve celulare përbën një treg të veçantë. Megjithatë, jemi të mendimit se termi “treg përkatës i veçantë” nuk është plotësisht i përdorur drejt. Pavarësisht kriterit të zëvendësimit të ofertës dhe kërkesës, apo nevojës për të terminuar SMS në rrjetin ku karta SIM merr shërbimin, edhe AKEP shprehet se natyra e shërbimit SMS është prekur nga mundësitë që ofron tregu.

(faqe 17 - treguesi i përdorimit të këtyre shërbimeve shpreh në mënyrë me bindëse efektin e zëvendësueshmërisë në përdorimin e SMS-ve në vend të thirrjeve telefonike, pa analizuar arsyet që mund të jenë marrë në konsideratë nga përdoruesi për të bërë zëvendësimin e këtyre dy shërbimeve (thirrje zanore me SMS).

Pergjigje e VF:

Vodafone Albania konsideron se percaktimi i tregut te terminimit me shumice te SMS, bie ndesh me kuadrin rregullator ekzistues te AKEP dhe te KE dhe eksperiencen me te mire ne fushen e komunikimeve elektronike.

1. Nga ana tjetër, perkufizimi i secilit treg terminimi me vete ne baze te rrjetit perkates te secilit operator celular eshte nje rrjedhoje logjike e praktikës ekzistuese te analizës se tregut me shumice te terminimit SMS ne Shqipëri te vitit 2011 por edhe ne BE per rastet e rralla qe eshte trajtuar terminimi i SMS. Sic jemi shprehur dhe me heret Vodafone eshte dakord ne parim qe ekziston tregu i terminimit me vete per secilin operator celular por qe nuk jemi dakord me analizen e konkurrencës te kryer per kete treg dhe shprehemi kunder rregullimit te tij.

Qendrimi AKEP:

Komentet e sjella per pyetjen nr.2, sidomos nga AMC kane te bejne kryesisht me trajtimin e zevendesueshmerise ne anen e kerkeses per sherbimin e SMS me sherbime te tjera. AKEP sjell ne vemendje se ka trajtuar zevendesueshmerine ketij sherbimi, rast pas rasti dhe per trajtim me te detajuar ka dhene per reference dokumnetin e analizës paraendese (2011). Por ajo qe ka rendesi ne trajtimin e bere, eshte fakti qe nuk perjashtohet aspekti i zevendesueshmerise se pjesshme, por cilesohet ne te gjitha rastet se nuk jemi ne kushtet e zevendesueshmerise se plote. Kjo perben edhe diferencen ne trajtimin e aspektit te zevendesueshmerise ne anen e kerkeses.

Nga VF dhe AMC, komentet e tyre kane te bejne kryesisht me mungesen e dakortesise per t'u marre ne analize sherbimi i SMS-ve, duke mos kundërshtuar faktin qe ne rastin e trajtimit perkufizimi i secilit treg terminimi me vete ne baze te rrjetit perkates te secilit operator celular eshte nje rrjedhoje logjike e praktikës ekzistuese te analizës se tregut me shumice te terminimit SMS ne Shqipëri te vitit 2011 por edhe ne BE.

Ne lidhje me komentin e VF se *“percaktimi i tregut te terminimit me shumice te SMS, bie ndesh me kuadrin rregullator ekzistues te AKEP dhe te KE dhe eksperiencen me te mire ne fushen e komunikimeve elektronike”*, theksojme se nje gje e tille nuk eshte e sakte, pasi eshte trajtuar edhe ne analizen pararendese dhe AKEP ka jo vetem kopetencen ligjore por edhe percaktimin e bere ne Rregullore nr. 9, datë 17.07.2009 “për analizën e tregut” (miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, ndryshuar meVKD nr.2342, date 31.07.2013) (neni 3, pika 2).

3. A mendoni se tregu me shumicë i terminimit të SMS-ve është treg i justifikueshëm për ndërhyrje/analize ex-ante (duke plotësuar testin e tre kritereve)?

Pergjigje e Altelecom Sh.a:

Altelecom mendon se tregu me shumicë i terminimit të SMS-ve është treg i justifikueshëm për ndërhyrje/analize ex-ante, pasi siç u trajtua edhe më lart, tregu nuk është në konkurrencë efektive, tarifat nuk janë të orientuara drejt kostos, tarifat standarde me pakicë janë në rritje, si edhe operatori me pozitë dominante në treg është duke ruajtur dhe forcuar këtë pozitë nëpërmjet praktikave të padrejta diskriminuese dhe antikonkurruese.

Pergjigje e AMC:

AMC, ashtu si dhe ne analizen e meparshme te vitit 2011, mbetet e mendimit qe tregu i terminimit te SMS-ve nuk eshte i justifikueshem per nje nderhyrje ex-ante nga ana e AKEP, pasi nuk evidentohet mungesa e konkurrencës efektive ne nivelin retail te tregut te SMS-ve. Nga Udhezuesi i BE-se 2002/C/165/03 per analizen e tregjeve dhe vleresimin e FNT , enti rregullator ndermerr nje analize tregu per percaktimin me FNT dhe ndermarrjen perkatese te masave rregullatore, duke u nisur nga kushtet aktuale ne te cilat ndodhet tregu perkates ne nivel retail.

Argumentat e parashtruara serish ne kete draft dokument nga ana e AKEP per plotesimin e testit te tre kriterëve ne tregun e terminimit te SMS-ve nuk qendrojne dhe pavaresisht formulimeve te AKEP, argumentimi i tij nuk eshte bindes.

AMC shprehet se terminimi i SMS-ve nuk eshte i justifikueshem per nje rregullim ex-ante.

Per shkak te zevendesueshmerise se sherbimeve te SMS-ve me sherbime te tjera te ngjashme me te nga ana e kerkeses dhe ofertes, sic jane emailt dhe MMS-te, me ane te te cilave konsumatori gjendet perballe nje mundesie me te madhe alternativash te tjera, si dhe licensimit te tre operatoreve AMC, Vodafone, Eagle Mobile, reflektohet nje situatë tregu ne terminimin e SMS-ve e karakterizuar nga mungesa e barrierave hyrese te larta per konkurrentet e tjere qe duan te hyjne ne treg per te ofruar sherbimet dhe produktet e tyre, pavaresisht politikave tarifore qe mund te ndjekin operatoret kryesore.

Prandaj, AMC mbetet serish e gjykimit qe edhe kriteri i pare qe justifikon nje nderhyrje rregullatore ex-ante ne treg nuk plotesohet. Ky konkluzion perforcohet akoma me teper dhe me ekzistencen gati tre vjecare te sherbimeve 3G ne treg, qe ka rritur ne menyre te kenaqshme nivelin e sherbimeve dhe produkteve te reja ne treg dhe mundesine e abonentëve per te zgjedhur dhe zevendesuar sherbimet, te cilat jane zevendesues direkt te sherbimeve SMS, pasi kane gjetur tashme nje perdorim masiv ne kategori te ndryshme abonentesh, sidomos tek moshat e reja.

Konkurrenca ne tregun e SMS-ve, sic kemi permendur dhe ne paragrafe te tjere eshte mjaft e evidente, per arsye te nje sere faktoresh, sic jane alternativat e ndryshme ne ofrimin e sherbimeve dhe produkteve (SMS, MMS, e-maile, futja e teknologjise 3G ne treg, etj), numri i larte i operatoreve ne treg duke marre parasysh dhe dimensionin e tregjeve ne vendin tone ne raport me numrin e banoreve. Ndaj dhe abuzimet qe mund te lindin nga pozitat dominante te operatoreve te ndryshem, te cilat mund te shkaktojne ate qe quhet “deshtime ne treg” jane shume te pakta, per te mos thene qe nuk ekzistojne. Ligji per konkurrencen i vitit 2003 i mbulon dhe i adreson mjaft mire ceshtjet qe kane lidhje me pozitat abuzuese dhe dominante ne treg qe cojne ne deshtime te formave te ndryshme ne treg, ndaj AMC mendon se eshte mese i mjaftueshem referimi per keto ceshtje ne ligjin mbi konkurrencen.

Si rrjedhoje, AMC gjykon qe edhe kriteri i trete qe lidhet me pamjaftueshmerine e ligjit mbi konkurrencen per te adresuar ceshtjet e deshtimit ne treg, nuk plotesohet.

Duke qene se ky treg nuk ploteson te tre kriteret qe justifikon nderhyrje ex-ante per vendosje te masave rregullatore, si dhe duke pasur parasysh faktin qe nuk ben pjese ne listen e tregjeve nen rregullim nga BE-ja dhe ku shumica e vendeve qe kane ndermarre nje nisme per analizen e ketij tregu nuk kane ndermarre masa rregullatore sic eshte rasti i Polonise dhe Danimarkes, **AMC ne konkluzion te kesaj pergjigje mendon qe ky treg te mos jete objekt rregullimi nga ana e AKEP-it , pasi nuk plotesohet testi i tre kriterëve, sic u permend ne paragrafet me siper.**

Pergjigje e Plus:

Në aspektin praktik, AKEP kur bën analizën e tregut del në konkluzion duke përdorur argumentat siç veprohet në analizen e tregut të shërbimit të thirrjeve. Ky konkluzion del si rrjedhojë e një deduksioni dhe jo si një kriter i mirëanalizuar, por një analogji me shërbimin e thirrjeve. (ref. Paraprakisht AKEP sjell në vëmendje se vetë analogjia që ka “shërbimi i terminimit” në të dy shërbimet e telefonisë së lëvizshme (thirrjet zanore dhe SMS), duke konsideruar edhe faktin që të dy këto shërbime janë komplementare të njëri-tjetrit dhe jo në zëvendësueshmëri të plotë, gjë e cila është trajtuar më sipër si dhe në analizën pararendëse, të orienton drejt konkluzionit që ky treg plotëson testin e tre kriterëve.

Përsa i përket kriterëve, PLUS është dakort me përcaktimin e tre kriterëve prej AKEP për ndërhyrjen/analizën ex-ante.

Pergjigje e VF:

Vodafone Albania konsideron se rregullimi i tregut te terminimit me shumice te SMS, bie ndesh me Rregulloren e AKEP dhe Rekomandimet e KE pasi tregu i terminimit me shumice te SMS nuk perfshihet ne listen e tregjeve te identifikuar per rregullim ex-ante ne fushen e komunikimeve elektronike sipas Rregullores per Analizen e Tregut te AKEP dhe as ne Rekomandimin e Komisionit European te dates 17

Dhjetor 2007⁴.Vodafone gjykon se Grupi i Punes ka deshtuar te argumentoje plotesimin e 3 kritereve te detyrueshmeperpara se te percaktoje nje treg te ri pertej Rekomandimeve te KE dhe tregjeve te percaktuara ne Rregulloren e Analizes se Tregut te AKEP (e rishikuar).

1. Ligji 9918 ne nenin 31 te tij percakton qartesisht se AKEP duhet te udhehiqet nga Rekomandimet e KE pergjate Analizave te tregut dhe percaktimit te tregjeve perkatese: *“Percaktimi i tregjeve, analiza e tyre dhe percaktimi i sipermarresve, qe kane fuqi te ndjeshme ne treg, ne tregjet perkatese, behet nga AKEP-i ne menyre periodike, por jo me pak se nje here ne dy vjet, ne baze te nje rregulloreje, te hartuar ne zbatim te ketij ligji dhe ne perputhje me rekomandimet perkatese te BE-se.”*
2. I njejti parim ri-forcohet dhe ri-theksohet ne nenin 32 ne vijim te Ligjit 9918: *“AKEP-i percakton tregjet perkatese kombetare te komunikimeve elektronike dhe produktet perkatese, te cilat justifikojne rregullimin dhe jane subjekte te rregullimit te veçante, ne perputhje me percaktimet e ketij ligji, me parimet e ligjit per konkurrencen dhe kushtet aktuale te tregut shqiptar, duke pasur parasysh kerkesat e rregullimit te veçante ne sektor dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian per tregjet perkatese te produkteve dhe sherbimeve.”*
3. Ne fakt te dy Rekomandimet e KE, edhe ai pararendes i vitit 2003⁵ por edhe ai i amenduar i vitit 2007, per asnje cast nuk e kane perfshire tregun e terminimit me shumice te SMS si nje treg i cili ka nevoje per rregullim ex-ante nga autoritetet rregullatore me qellim konkurrencen efektive ne tregun e komunikimeve elektronike. Pergjate fushates konsultuese ne vitin 2006 me qellim rishikimin e Rekomandimit te vitit 2003, ne dokumentin mbeshtetes Komisioni Evropian ka sqaruar dhe arsyet pse nuk eshte e nevojshme qe terminimi me shumice i SMS te perfshihet ne listen e tregjeve qe kane nevoje per nderhyrje ex-ante por Grupi i Punes se AKEP e ka anashkaluar kete qendrim.
4. Tregu i terminimit te SMS nuk eshte ne listen e tregjeve subjekt i rregullimit ex-ante te Rregullores per Analizen e Tregut te AKEP, prandaj nevojitet argumentimi detajuar, justifikuar dhe bindes i plotesimit te 3 (tre) kritereve, cka merr nje rendesi thelbesore perpara vleresimit te rregullimitte tregut te terminimit te SMS-ve. Ne kete kuader Vodafone gjykon se AKEP nuk ka justifikuar dhe argumentuar ne menyre bindese kete nderhyrje per asnje moment, cka vjen ne kundertshti me parashikimet e Rregullores per Analizen e Tregut,Rekomandimete KE dhe praktikene gjere europiane.
5. Nga ana tjeter, qellimi i rregullimit nga ana e AKEP ngelet i paqarte dhe i pajustificuar dhe teresisht jo-proporcional.Pajtimtaret perfitojne aktualisht tarifa te ulta dhe plotesisht te aksesueshme; krahasimi i tarifave te SMS-ve ne Shqiperi me mesataren rajonale (qofte ne nivel pakice por edhe shumice) tregon nje situatë mese te pranueshmedhe konkurruese, e per pasoje nuk justifikon nderhyrjen dhe rregullimin e tregut.
6. Mesatarja e tarifave te terminimit te SMS ne vendet anetare te BE-se eshte me e larte se ajo e Shqiperise – konkretisht 2.47 Eurocent/SMS kundrejt 1 Eurocent/SMS ne Shqiperi. Sipas shifrave te permendura nga vete AKEP ne Analize, por edhe te detajuara ne vijim nga Vodafone tarifate terminimit te SMS ne BE variojne nga 0.6 deri ne 5.6 Eurocent/SMS. Ne tabelen krahasimore prej 25 vendesh, vetem 3 shteteqendrojne me tarifa lehtesisht me te ulta ose te krahasueshme me Shqiperine).Kjotregon qartesisht se nje treg i tille nuk ka nevoje per nderhyrje ex-ante.

Qendrimi AKEP:

Komentet e sjella per kete pyetje kane tendencen e zgjatjes dhe te perseritjes se vazhdueshme te argumeneteve te njejte, qe kryesisht kane te bejne me:

⁴Rekomandim i Komisionit Evropian ‘Mbi tregjet e sherbimeve dhe produkteve relevante ne fushen e komunikimeve elektronike, qe kane nevoje per rregullim ex-ante ne perputhje me Direktiven 2002/21/EC te Komisionit Evropian dhe Keshillit ‘Mbi kuadrin rregullator te perbashket per sherbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike, 2007/879/EC

⁵Rekomandim i KE i dates 11 Shkurt 2003 ‘Mbi tregjet e sherbimeve dhe produkteve relevante ne fushen e komunikimeve elektronike, qe kane nevoje per rregullim ex-ante ne perputhje me Direktiven 2002/21/EC te Komisionit Evropian dhe Keshillit ‘Mbi kuadrin rregullator te perbashket per sherbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike, 2003/311/EC

- zëvendësueshmerine e shërbimit të SMS në anën e kërkesës;
- faktin që ky treg nuk ndodhet në listen e tregjeve sipas rekomandimeve të KE-se (2003 dhe 2007) si dhe në listen e tregjeve të përcaktuara nga AKEP;
- faktin që kanë nderhyre shumë pak vende etj;

Keto argumente vijnë nga dy operatorët VF dhe AMC, pasi komentet e sjella nga Albtelecom dhe Plus e konsiderojnë të nevojshme përcaktimin e këtij tregu si dhe nderhyrjen e ex-ante.

Një pjesë e qëndrimit të AKEP për komentet e sjella për pyetjen 3, vlen në qëndrimin e mbajtur rreth komenteve për pyetjen nr.2, por gjithësesi në plotësim të këtij qëndrimi sjellim në vëmendje të VF dhe AMC se AKEP ka provuar në mënyrë të mjaftueshme 3 kriteret e duhura që lejojnë analizimin e tregut të terminimit të SMS-ve, duke mos vënë në dyshim se ky treg nuk është në listen e tregjeve të KE-se (2003 dhe 2007), por duke qenë në kompetencën e vete institucioneve kombëtare (autoriteteve rregullatore) ta gjykojë ose jo të arsyeshme në varesi të rrethanave kombëtare dhe e gjykon në favor të zhvillimit të metejshëm të konkurrencës në këtë treg dhe si një mundësi shtesë për rritur përfitimin e përdoruesve të këtij shërbimi. Të gjithë grafikët e përdorur në analizë nga AKEP (përvoja nga vendet e tjera), apo edhe ilustrimet e sjella nga VF dhe AMC janë faktore shtesë që përforcojnë bindjen se arsyet që tarifat e terminimit për shërbimet e terminimit në rrjetet e vecanta të ndryshojnë apo të shkojnë në kosto eficientë të tyre (përfshirë tarifën e terminimit të SMS-ve), sa kohë që modeli i pagesës është “*pala origjinuese e SMS-se, paguan*”, ka pak ose aspak nxitje e brendshme ekonomike për operatorët për të vendosur normat e tyre të terminimit në një nivel “konkurruese” (niveli që mund të pritët, në qoftë se shërbimet e terminimit celular ishin subjekt i konkurrencës efektive), pasi nuk ka zëvendësues të vërtetë që mund të detyrojnë sjelljet e operatorëve celularë, për rrjedhojë ka pak ose aspak nxitje e brendshme ekonomike për operatorët e telefonisë celulare për të ofruar shërbime terminimi në aspektin ekonomik dhe teknik (të shërbimeve të interkoneksionit). Ky fakt ilustron qartësisht edhe forcën e faktorit “fuqi kundërvpuesë”, të cituar nga VF.

4. A mendoni se të katër operatorët celularë aktivë në treg, përmbushin kriteret për FNT në terminimin e SMS-ve në rrjetet tuje?

Përgjigje e Albtelecom Sh.a:

Vetë natyra e këtij tregu e përcaktuar që në përkufizimin e tij, si një shërbim i natyrës monopolistike, justifikon faktin se çdo operator celular ka FNT në rrjetin individual të tij për shërbimin e terminimit të SMS-ve. Por, shprehemi dakord me AKEP për trajtimin në mënyrë të diferencuar të faktorëve të tjerë të cilët kanë të bëjnë me pjesët e tregut të operatorëve, bazën e pajtimtarëve të tyre dhe shpërpjestimin e theksuar të trafikut mes operatorëve të mëdhenj dhe të vegjël.

Në kushtet kur operatorët kanë pjesë tregu shumë të ndryshme mes tyre (Eagle Mobile rreth 12 here me pak se Vodafone Albania), shoqëruar kjo edhe me politikën e tarifimit agresiv nga kompanitë me pozitë dominuese, është e pamundur që të pretendohet një trafik i balancuar i shërbimeve të interkoneksionit, rrjedhimisht dhe i shërbimit të SMS. Në një situatë të tillë është e rëndësishme ndërhyrja e Autoritetit Rregullator për të garantuar aplikimin e tarifave jo diskriminuese dhe të orientuara në kosto.

Albtelecom gjykon se megjithë prezencën e një numri të madh të paketave ofertuese, sërisht është e mundur që grupe të specializuara të ngritura për këtë qëllim mund të përcaktojnë tarifën mesatare për secilin nga shërbimet e ofruara pajtimtarit në oferta të ndryshme, duke garantuar efektivisht në këtë mënyrë zbatimin e ligjit dhe ndalimin e tarifave diskriminuese dhe të pa orientuara drejt koston.

Përgjigje e AMC:

Nëse AKEP do të vendosë për rregullimin e këtij tregu, të katër operatorët që kanë FNT në këtë treg duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë, pra rregullimi duhet të jetë simetrik në vendosjen e tarifave përkatëse të terminimit për të katër operatorët.

Pergjigje e Plus:

Në bazë të analizës analogjike me shërbimet e thirrjeve dhe argumentave të përdorur nga AKEP, operatorët celularë që veprojnë në tregun me shumicë të shërbimeve SMS mund të konsiderohet operatorë me fuqi të ndjeshme në treg për shërbimin në fjalë.

Për vetë zhvillimet e ndodhura dhe tendencën për të përqëndruar pajtimtarët kryesisht në grupe të mbyllura apo ngurtësimin e bazës së pajtimtarëve brenda rrjetit, PLUS mbështet qëndrimin e AKEP për të trajtuar në mënyrë më të diferencuar disa faktorë të tjerë që kanë të bëjnë kryesisht me asimetrinë e trafikut të zhvilluar (volumit të SMS-ve të shkëmbyera) ndërmjet rrjeteve si marrëdhënie interkoneksioni ndërmjet tyre dhe mundësite egzistuese për shtrembërime të konkurrencës.

Pergjigje e VF:

Vodafone Albania perserit se AKEP nuk duhet të nderhyjë në tregun e terminimit të SMS. Por edhe nëse hipotetikisht AKEP do duhej të nderhynte në tregun e terminimit të SMS (çka nuk duhet), atëherë të kërkohet nga operatorët në treg përmbushin kriteret për FNT në terminimin e SMS-ve dhe ata duhet të trajtohen të gjithë në mënyrë të njëjtte dhe pa asnjë diskriminim.

Qendrimi AKEP:

Në thelb të komenteve të secilit nga operatorët, pavarësisht perseritjes së kundërshtive për të mos nderhyrë në këtë treg, konkluzioni i tyre është i njëjtte, duke vlerësuar se: nëse AKEP do duhej të nderhynte në tregun e terminimit të SMS, atëherë të kërkohet nga operatorët në treg përmbushin kriteret për FNT në terminimin e SMS-ve.

5. Cili është mendimi juaj për vazhdimin e masave rregullore të vendosura në analizen pararendese dhe arsyet e konsideruara?

Pergjigje e Altelecom Sh.a:

Altelecom gjykon se tregu i SMS ka nevojë për ndërhyrje efikente rregullore jo vetëm në terminim por edhe në tregun e pakicës ku kemi rritje të tarifave standarde në dëm të konsumatorit.

Pergjigje e AMC:

AMC në analizen pararendese është shprehur kundër aplikimit të masave rregullore për terminimin e SMS-ve në rrjetet celulare.

Gjithashtu, në qëndrimin e shprehur nga AMC në analizen e 2011, tarifat për SMS MT duhet të jenë të një niveli rekomandues, ku operatorët duhet të bazohen me tej në percaktimin e tyre. Pozicioni ynë mbi këtë çështje ngelet i njëjtte, duke qenë se kemi të bëjmë me një treg që nuk është i justifikueshëm për të qenë nën rregullim, si dhe shfaq tipare dalluese nga terminimi i thirrjeve zanore.

Ndaj dhe niveli i tarifave të propozuara nga AKEP duhet të jetë i një niveli rekomandues për operatorët sipas atij aktual prej 1.44 leke/SMS, pasi një reduktim i metejshëm siç propozohet në dy alternativat e tjera cenon pozitativisht operatorët, meqenëse tregu i terminimit të SMS-ve nuk i plotëson kushtet për rregullim sipas mendimit tonë.

Propozimi i AKEP për rregullimin asimetrik midis operatorëve është një kthim prapa në kohë dhe nuk respekton parimet bazë rregullore në trajtimin e barabartë të tyre. Vendosja e masave të tilla rregullore është i pajustificueshëm dhe demton konkurrencën e ndershme në treg, nuk është i mireargumentuar, pasi favorizon disa operatorë dhe demton operatorët e tjerë, siç është rasti i AMC-se, duke imponuar tarifa të ndryshme terminimi për një periudhë tranzicioni nga 1 Mars 2014 deri më 1 Shtator 2015, gjatë së cilës mund të krijohen situata abuzive në treg nga ana e dy operatorëve të tjerë të favorizuar nga ky rregullim. Nuk kuptohet se ku është bazuar AKEP në percaktimin e kësaj periudhë tranzicioni, pasi nuk e ka mbështetur as në fakte ose në evidenca.

Keto masa rregullore nuk kanë për të pasur efekte të konsiderueshme në tregun me pakicë, që është tashmë shumë kompetitiv, pasi terminimi përfshin vetëm interkoneksionin midis operatorëve mobile, dhe AKEP nuk ka marrë në konsideratë shërbimet e tjera të zëvendësueshme që kanë një ndikim të ndjeshëm

ne konkurrencen e operatoreve ne tregun e SMS-ve sic jane push SMS, apo dhe sherbimet e tjera te instant messaging ne forme teksti (email, viber, etj) me ane te teknologjise 3G.

Propozimi per vazhdueshmerine e aplikimit te masave rregullatore per terminimin e SMS-ve nuk eshte me i nevojshem, pasi eshte rritur dukshem niveli i konkurrences ne treg, duke qene se kushtet e tregut kane ndryshuar ne menyre evidente. Ndaj, ne perputhje me kushtet e reja te krijuara ne treg, AKEP duhet te rishikojte dhe njehere pozicionin e tij ne lidhje me aplikimin e masave rregullatore, pasi tashme ato rezultojne te panevojshme me situaten e re te krijuar.

Me i dukshem eshte ky fakt po te bejme krahasimin midis tarifave te terminimit te propozuara nga AKEP dhe tarifave te vendeve te bashkimit europian sipas grafikut te marre nga raporti I BEREC per Korrik 2013, duket qarte se tarifat e propozuara nga AKEP jane jashtezakonisht me te ulta se mesatarja e shumices se vendeve te BE apo ato te vendeve te EU te cilat i kane rregulluara (Franca). Le te krahasojme variantin e dyte te propozuar nga AKEP me vlerat mesatare te BE dhe me vleren me te ulet dhe me te larte te BE:

	Aktuale	1 Mars 2014	1 Shtator 2014	1 Shtator 2015
Vodafone	0.01Euro/SMS ose 1.44 leke/SMS	0.007 Euro/SMS ose 1.00 leke/SMS	0.004 Euro/SMS ose 0.58 leke/SMS	0.004 Euro/SMS ose 0.58 leke/SMS
AMC	0.01Euro/SMS ose 1.44 leke/SMS	0.007 Euro/SMS ose 1.00 leke/SMS	0.004 Euro/SMS ose 0.58 leke/SMS	0.004 Euro/SMS ose 0.58 leke/SMS
EM	0.01Euro/SMS ose 1.44 leke/SMS	0.007 Euro/SMS ose 1.00 leke/SMS	0.004 Euro/SMS ose 0.58 leke/SMS	0.004 Euro/SMS ose 0.58 leke/SMS
PLUS Communication	0.01Euro/SMS ose 1.44 leke/SMS	0.007 Euro/SMS ose 1.00 leke/SMS	0.004 Euro/SMS ose 0.58 leke/SMS	0.004 Euro/SMS ose 0.58 leke/SMS
Mesatarja e BE	0.0 247 Euro/sms	0. 0247 Euro/sms	0. 0247 Euro/sms	0. 0247 Euro/sms
Tarifa me e ulet e BE Turqia	0.0018 Euro/SMS	0.0018 Euro/SMS	0.0018 Euro/SMS	0.0018 Euro/SMS
Tarifa me e larte e BE	0.056 Euro/sms	0.056 Euro/sms	0.056 Euro/sms	0.056 Euro/sms

Pergjigje e Plus:

PLUS është dakort me qëndrimin e AKEP për sa i përket mungesës së konkurrencës së ndershme në treg, kryesisht në tendencën e operatorëve për të ofruar shërbim preferencial, të favorshëm në tarifa, vetëm brenda grupeve, ose rrjetit, duke diskriminuar përdoruesit që përdorin shërbimin jashtë grupit.

Për arsyet e lartpërmendura, PLUS mbështet AKEP për ndërhyrjen në tregun me shumicë dhe atë me pakicë në shërbimin SMS në Shqipëri.

Pergjigje e VF:

Vodafone Albania konsideron se masat e propozuara nga AKEP per rregullimin e tregut bien ndesh me kuadrin ligjor dhe rregullator ekzistues, nuk jane proporcionale per te arritur qellimin dhe objektivat dhe si te tilla nuk jane ne perputhje me parimet e percaktuara ne Direktiven Kuader dhe Ligjin 9918.

4. Direktiva Kuader percakton qarte ne nenin 8 te saj se masat e ndermarra nga autoriteti rregullator ne rast rregullimi ex-ante duhet te jene proporcionale, me qellim permbushjen sa me efektive te objektivave te meposhtem:
 - nxitje e konkurrences per ofrimin e rrjeteve te komunikimeve elektronike;
 - dhenie kontributi per zhvillimin e tregut te perbashket europian; dhe
 - promovim i interesit te qytetareve;
5. Per te shkuar edhe me tej, KE percakton se se vendosja e masave ex-ante eshte hapi i fundit qe duhet ndermarre per te rregulluar nje treg te caktuar, kur cdo tentative tjeter e meparshme ka deshtuar te sjelle konkurrencen netreg. Kjo Direktive, gjithashtu u kerkon autoriteteve rregullatore qe duhet te arrijne nepermjet bisedimesh instrumentin e duhur dhe masen me te pershtatshme per te adresuar situatat e vecanta ne treg. Udhezimet mbi analizen e tregut percaktojne se nje mase e ndermarre qe te jete proporcionale duhet te synoje nje qellim legjitim dhe kjo maseduhet te jete me e lehta e mundshme apo minimale per te arritur qellimin ne fjale.⁶
 - Nje studim i ndermarre nga ITU tregon se manovra e ARCEP per percaktimin e tregut te SMS, nuk ndikoi ne rritjen e konkurrences midis operatoreve ne nivel shumice⁷.
 - Praktika e vendeve si Danimarka dhe Franca, kane treguar se KE e ka pare percaktimin e tregut te SMS si nje mase qe potencialisht rrezikon levizjen e lire te sherbimeve brenda tregut pan-europian dhe diskriminon operatoret e huaj.
 - Percaktimi i tregut te SMS (shoqeruar nga rregullimi i tarifave) ul mundesine e fleksibilitetit te ofertave dhe paketave me SMS me tarife te ulet, cka ne fund shnderrohet ne efekt negativ per buxhetin e perdoruesve fundore.
6. Gjithe sa me lart, tregojne qartazi qe inisiativa e AKEP nuk eshte masa e duhur ne perputhje me parimet europiane per t'u ndjekur ne rast se synohet nje treg me kompetitiv, pasi sugjerimet e dhena ne dokumentin per konsultim jane teresisht jo-proportionale.
7. AKEP synon te imponoje te gjithe 'arsenalin' e masave rregullatore per tregun e terminimit te SMS-ve. Sic e permendem, edhe pse nuk ka nje praktike europiane te pranuar gjeresisht (per faktin e thjeshte se ky treg nuk duhet te rregullohet), parimet orientuese baze jane qe rregullimi duhet te jete sa me i kufizuar dhe gjithmone te jete proporcional dhe i justifikuar. Ne kushtet e tregut shqiptar, kur analiza e vete tregut te pakices dhe faktoreve te tij tregon per konkurrence efektive, te pretendosh se masat rregulluese te tregut te shumices duhen aplikuar te gjitha dhe se ato jane proporcionale, eshte plotesisht e pakuptimte.
8. Parimi i proporcionalitetit pranohet qartesisht dhe nga ligjvenesi shqiptar ne nenin 34 te Ligjit 9918: *“Detyrimet e vendosura ne perputhje me kete nen bazohen ne natyren e problemit te identifikuar dhe duhet te jene proporcionale e te justifikuara nga pikepamja e objektivave rregullatore te vendosura ne nenin 7 te ketij ligji.”*

Nevoja per rregullim te metejshem te tregut nuk mbeshetet nga Ligji 9918 per sa kohe tarifat jane nen nivelet krahasimore te vendeve te BE dhe rajonit

9. Propozimi i AKEP per rregullim te metejshem te tregut te terminimit te SMS nuk eshte ne perputhje me Ligjin 9918 “Per Komunikimet Elektronike ne RSH”, neni 53/2 ku *“qellimi i rregullimit te*

⁶ Udhezues i Komisionit Europian mbi analizen e tregut dhe vleresimi fuqise se ndjeshme ne treg sipas Kornizes Rregullatore te Komunitetit per sherbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike (Commission Guidelines on market analysis and the assessment of significant market power under the Community Regulatory framework for electronic communications networks and services), 2002/C 165/03

⁷ Prezantim i ITU, Antonio Zagaballos, Mars 2010; Analiza SMS, probleme dhe mundesi (SMS- analysis, Problems and Opportunities)

tarifave eshte parandalimi i sjelljeve antikonkurruese dhe i diskriminimit te perdoruesve fundore dhe konkurruesve ne treg qe mund te rezultojne nga veprimet e sipermarresit me fuqi te ndjeshme ne treg.” Vodafone Albania gjykon se ne fakt pajtimitaret perfitojne cmime te ulura si pasoje e konkurrences se shtuar, ndaj dhe tregu nuk ndodhet aspak ne kushtet e nevojës per rregullim ex-ante. Nga ana tjetër nuk ekziston asnje e dhene qe tregu ndodhet ne kushtet e sjelljes anti-konkurruese apo diskriminimit.

10. Gjithashtu ne nenin 57.2 pikat **a** dhe **b**, ligjvenesit ka percaktuar se AKEP duhet te marre ne konsiderate pergjate ketij rregullimi tarifat mesatare te BE dhe tarifat e vendeve te rajonit me zhvillim te ngjashem me Republiken e Shqiperise. Ne kete rast vete AKEP ka pranuar ne Analizen fillestare te kryer se cmimet e ofruara ne nivel shumice nga operatorët celulare ne Shqiperi jane me te ulte se ne te gjithë vendet e tjera te BE (perjashto Turqi, Qipro dhe Lituani) dhe rajonit, cka serish bie ndesh me percaktimet e nenit 57/2 dhe nuk justifikon aspak nevojën dhe proporcionalitetin e rregullimit te propozuar (shiko faqet 33, 34, 39 dhe 40 te Analizes se AKEP).
11. Sic e permendem dhe me lart, ulja e theksuar dhe e vazhdueshme e detyruar e tarifave te terminimit ekspozon ne nje mase te caktuar tregun e komunikimeve elektronike ndaj krizes ekonomike, e per rrjedhoje rezulton ne investime te munguara dhe nivel te ulet arketimi taksash. Ne kete kuader Vodafone deshiron ti kujtoje AKEP se aplikimi i tarifave me te uleta ne nivel shumice krahasuar me vendet fqinje te rajonit ekspozon operatorët shqiptare ne menyre negative dhe diskriminuese ndaj operatorëve fqinje, te cilet fale tarifave te terminimit me te larta kane mundesi me te medha per te ri-investuar ne rrjete, sherbime dhe jane keshtu me kompetitive dhe fitimpures ne nivel rajonal.

Modelimi i koston per tarifen e terminimit te SMS nuk eshte diskutuar me operatorët dhe kjo eshte ne shkelje te neneve 57, 58, 59 te Ligjit 9918.

12. Nuk ekziston nje analize kostoje per SMS ne nivel terminimi dhe AKEP nuk ka diskutuar me operatorët modelin e kalkulimit te kostove dhe arritjen e perfundimeve te publikuara ne kete dokument. Vodafone Albania eshte njohur me ‘glide path’ te propozuar per SMS vetem ne perfundim te analizes se koston sipas modelit BULRAIC per terminimin e thirrjeve zanore ne Shkurt 2011. Vodafone Albania-s nuk i eshte vendosur ne dispozicion asnje dokument apo analize ekonomike se si eshte arritur ne kete perfundim dhe nuk i eshte kerkuar asnje mendim paraprak apo te dhena mbi kalkulimin e koston per terminimin e SMS. Kjo mungese transparence dhe mos-perfshirje e aktoreve te interesuar vjen ne kundërshtim me Ligjin 9918, perkatesisht nenet 56, 57, 58 dhe 59. AKEP duhet te veproje per analizen e kostove te SMS ne menyre te ngjashme sic ndodh me modelimin e kostove per terminimin e thirrjeve zanore.
13. AKEP ka kryer nje proces tejet te nderlikuar dhe kompleks (duke pajtuar konsulente te huaj te specializuar) qe te dilte ne nje rezultat te pranueshem per te modeluar koston e terminimit te telefonatave te nje operatori eficient ne tregun shqiptar. Nderkohe deri me sot nuk eshte ndermarre nga AKEP asnje proces formal apo informal per te perllorgaritur dhe identifikuar koston e ofrimit te sherbimit te SMS ne nivel shumice. Ndaj eshte e pamundur dhe jo ne perputhshmeri ligjore qe AKEP te dale me nje perfundim te tille dhe te pretendojte se ka identifikuar koston e SMS ne nivel shumice.
14. E njejta gje thuhet per metoden benchmarking, ku vete AKEP ka pranuar dhe statistikat e tregojne qartesisht se ne rast te aplikimit te kesaj metodologjie, tarifat ekzistuese te terminimit te SMS jane plotesisht ne nivelet me te ulte te mundshme krahasuar me praktiken Europiane dhe patjeter qe nen nivelin mesatar te tyre.

Qendrimi AKEP:

Para se gjithash, AKEP sqaron se masa rregullatore jane te zbatueshme vetem per marredheniet e interkoneksionit mes operatorëve publike te rregjistruar tek AKEP dhe nuk perfshijne Push-SMS, apo forma te tjera mesazhes qe nuk kane per origjine rrjetet celulare.

Eshte bere e qarte edhe ne dokumentin per keshillim publik, se vendosja e masave rregullatore ka per qellim stimulimin e metejshej te rregullimit te mjedisit konkurrues ndermjet operatorëve celulare dhe ne kushtet kur pesha kryesore e trafikut te zhvilluar po orientohet brenda rrjetit (kjo vlen edhe per sherbimin e thirrjeve zanore), pasi aktualisht AKEP ka ne keshillim publik nje “glide path” te ri per tarifat e

terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, të miratuar me VKD Nr. Nr. 2412, datë 16.01. 2014, Për “Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”, i cili rekomandon midis të tjerave rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare sipas metodës BU-LRIC të pastër (duke përdorur metoden e nivelit të benchmark të vendeve që e kanë ndërtuar këto modele për përcaktimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare).

Per sa i përket komentit të Vodafone për konsultimin e rezultateve për koston BULRAIC, kjo është zhvilluar në kohën e duhur dhe në dokumentacionin e publikuar nga AKEP më 29.12.2010 dhe 10.02.2011 dhe AKEP ka mbajtur të njëjtin qëndrim në lidhje me këto edhe në analizën pararendëse.

Komenti i sjelle nga VF, sipas të cilit në nenin 57.2 pikat **a** dhe **b**, ligjvënasi ka përcaktuar se AKEP duhet të marrë në konsideratë përgjate këtij rregullimi tarifat mesatare të BE dhe tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë, vihet re një pasaktësi e përdorur nga VF, pasi nën 57.2 pikat **a** dhe **b**, referojnë: a) praktikën më të mirë të vendeve të BE-së; b) tarifat mesatare të vendeve të BE-së, dhe AKEP e konsideron si të arsyeshme në kushtet e tregut celular në Shqipëri dhe konfiguracionin e zhvillimit të trafikut (kryesisht on-net dhe në grupe të mbyllura) uljen e metejshme të tarifës së terminimit si për shërbimin e terminimit të SMS-ve dhe në vijimesi edhe për shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore.

Referencat e përdorura nga AMC dhe VF (të cilët kundërshtojnë vendosjen e masave rregullatore), por edhe arsyetimin dhe ilustrimet e përdorura nga Altelecom në mbështetje të vendosjes së masave rregullatore me qëllim zvogëlimin e efektit negativ që sjell politika tarifore diskriminuese, janë të trajtuara në dokumentin e analizës, në pjesën ku analizohet asimetria e trafikut për shërbimet e interkoneksionit, efektin negativ të shfaqur në pagesat e kryera ndërmjet rrjeteve të mëdha dhe rrjeteve të vogla, tendencën për zhvillimit të trafikut brenda rrjeteve (apo grupeve të mbyllura), duke tentuar një situatë disfavorizuese për operatorët me baze të vogël pajtimtare dhe rrjedhimisht në një të ardhme edhe ndikim në arritjen e konkurrencës efektive në shkallën maksimale të saj.

Vlen të theksohet se në masat rregulluese, AKEP ka vendosur të heqë detyrimin për ndarjen e llogarive për terminimin e SMS-ve, e cila përben një lehtësim të detyrimeve aktuale të operatorëve celulare.

6. A jeni dakort me propozimin e AKEP për zgjedhjen e Alternatives 3 për rregullimin e tarifave të terminimit të SMS-ve?

Pergjigje e Altelecom Sh.a:

Asimetria në tarifën e interkoneksionit përfaqëson një praktikë të zbatuar nga autoritetet rregullatore europiane gjatë periudhës së konvergencës së shpenzimeve drejt koston referencë. Reduktimi i asimetrisë së tarifave të terminimit midis operatorëve është bërë duke kryer vlerësimin e kostove nëpërmjet metodës afatgjatë për koston shtesë (LRIC). Rrethanat që justifikojnë mbajtjen e një asimetrie tarifore kalimtare lidhen, kryesisht, me ekzistencën e shpërpjestimeve në raportet e trafikut midis operatorëve, shumëfishuar nga faktori i diferencës midis tarifave të terminimit dhe kostove. Në përvojën e rregullatorëve europianë, asimetria ka vepruar si mekanizëm në korigjimin e efekteve negative të shkaktuara nga disnivelet e larta të pjesëve të tregut të terminimit të thirrjeve zanore, SMS etj., si dhe në raportet e tarifave me koston përkatëse.

Një situatë të ngjashme paraqet tregu i telefonisë mobile në vendin tonë, në të cilin operatori dominant Vodafone zotëron 73% pjesë tregu të SMS-ve dalës, si dhe afërsisht 4 herë më shumë pjesë tregu të terminimit të SMS-ve se Altelecom. Bilanci negativ në raportet e pagesave të interkoneksionit të Altelecom ndaj Vodafone dhe AMC stimulohet, krahas shpërpjestimeve të pjesëve përkatëse të tregut, edhe nga një faktor tjetër jo me pak peshë në marrëdhëniet midis operatorëve. Konkretisht, ky shpërpjestim ka ardhur duke u rritur edhe për shkak të diferencës që ekziston midis tarifave të interkoneksionit të rregulluara nga AKEP për SMS-të (1.44 lek/SMS aktualisht) dhe koston përkatëse të rezultuar sipas metodologjisë BU-LRAIC, e cila është llogaritur rreth 2.5 herë më e vogël se tarifa aktuale.

Raportet e trafikut si edhe aplikimi i tarifave të terminimit mbi koston e kanës dhënë një avantazh të padiskutueshëm financiar dy operatorëve dominantë në treg, dhe njëkohësisht e kanë shndërruar operatorin Altelecom (Eagle Mobile) në “pagues neto” kronik sa i përket bilancit të interkoneksionit si

për thirrjet telefonike ashtu dhe për SMS. Në pikpamjen ekonomike kjo përkthehet në ulje të aftësisë konkurruese dhe ulje të efijencës së Eagle Mobile.

Ecuria e tarifave të interkoneksionit të SMS

Operatorët	31 Dhjetor 2011	1 Janar 2012-31 Gusht 2012	1 Shtator 2012-31 Mars 2014	1 Mars 2014-31 Gusht 2014	1 Shtator 2014-31 Gusht 2015	1 Shtator 2015 -
Vodafone	3.00	2.00	1.44	1.00	0.58	0.58
AMC	3.00	2.00	1.44	1.00	0.58	0.58
Albtelecom/ Plus	3.00	2.00	1.44	1.00	0.58	0.58

Burimi: AKEP, analizat e tregut të SMS, viti: 2011, 2013

Analiza e ecurisë së tarifave të terminimit (tabela 1) tregon se operatorët dominantë Vodafone dhe AMC kanë përfituar gjithë avantazhet e pjesëve të larta të tregut të terminimit të SMS-ve si dhe diferencat e ndjeshme të tarifave me koston për një periudhë të konsiderueshme Mars 2008 - Mars 2014 (plus periudhën e pararegullimit). Duke shfrytëzuar avantazhet e rrjetit për një periudhë relativisht të gjatë ata vijuan të rritin në mënyrë progresive pjesët përkatëse të tregut. Ndërkohë, aplikimi i asimetrisë së përkohshme nga 1 Mars 2014 - 31 Gusht 2015, siç propozohet, sjell për operatorët e hyrë më vonë në treg një efekt gati të papërfillshëm. Kjo si rrjedhojë e diferencave mjaft të vogla ndërmjet tarifave (përkatësisht: 1/1.44 lek/SMS nga 1 Mars 2014-31 Gusht 2014; 0.58/1 lek/SMS nga 1 Shtator 2014-1 Shtator 2015), dhe për një periudhë mjaft të kufizuar, prej një viti e gjysëm. Për më tepër, edhe pse ndryshimi absolut midis tarifave të terminimit në Vodafone/AMC dhe Albtelecom/Plus është i vogël, operatorët dominantë do të vijojnë të jenë të favorizuar jo vetëm nga shpërpjestimet në rritje të pjesëve të tregut të SMS, por edhe praktikave jokonkurruese të përdorura gjerësisht si ato të “efektit të klubit” të realizuara nëpërmjet paketave “bundle”.

Nisur nga pjesët e tregut të operatorëve celularë për SMS-të dalëse për vitin 2012 dhe për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2013, si dhe duke parë vazhdimësinë e trafikut të SMS-ve për vitin 2013 deri në muajin Nëntor 2013, rregullimi i tarifave të terminimit sipas propozimit të AKEP në Alternativën 3 nëpërmjet lejimit të një asimetrie midis tarifave të terminimit të Albtelecom dhe tarifave të AMC e Vodafone e zbut disi humbjen e Albtelecom që vjen nga disbalancimi i trafikut të interkoneksionit të krijuar veçanërisht si rezultat i efekteve të rrjetit.

Ajo që vlen të theksohet është se efekti i rrjetit ka një peshë të rëndësishme në asimetrinë e trafikut të zhvilluar për shërbimet e interkoneksionit (në këtë rast edhe shërbimi i terminimit të SMS-ve) duke u stimuluar akoma më shumë nga paketat “bundles”, të ofruara nga të gjithë operatorët e rrjetit të telefonisë së lëvizshme.

Në përfundim, Albtelecom shpreh besimin në konsiderimin nga AKEP të sugjerimeve të mësipërme, në funksion të zhvillimit të konkurrencës efektive në tregun e SMS-ve në Shqipëri dhe dhënien e mundësisë reale pajtimtarit për përfitime të mundshme në lidhje me këtë shërbim.

Pergjigje e AMC:

AMC shprehet kundër propozimit të AKEP për zgjedhjen e Alternativës 3 për rregullimin e tarifave të terminimit të SMS-ve, pasi vendosja e tarifave asimetrike midis AMC/Vodafone dhe Eagle/PLUS është diskriminuese dhe në shkelje të kuadrit rregullator të BE-se dhe të Ligjit nr.9918, i ndryshuar për komunikimet elektronike, në kundërshtim me parimin e mos-diskriminimit dhe trajtimit të njëjtes midis operatorëve, duke favorizuar hapur dy operatorët e tjerë që kanë hyrë më vonë në treg, dhe duke caktuar në mënyrë arbitrare një periudhë tranzicioni për aplikimin e asimetrisë së tarifave deri më 1 Shtator 2015. Shkalla e asimetrisë në nivel rreth 30% nga 1 Mars 2014 – 1 shtator 2014 është e pabazuar, duke qenë se dy operatorët e tjerë Eagle dhe Plus tashmë kanë disa vite që operojnë në treg dhe kanë një bazë të konsoliduar të abonentëve të tyre si dhe të pozitave financiare në treg, dhe një kjo asimetri nuk është e justifikueshme, duke cenuar se teperi financat e AMC-se në këtë rast dhe duke e vendosur në pozita të qarta diskriminuese. Është e habitshme se si kjo masë rregullatore për aplikimin e asimetrisë ndërmerret nga AKEP në këtë moment, kur gjatë fazës së parë të analizës 2011, AKEP përcaktoi të njëjten tarifë terminimi të SMS-ve për të gjithë operatorët, kur duhet theksuar se në atë periudhë dy operatorët e tjerë kishin më pak kohë që operonin në treg, ndërsa sot ata kanë pozita solide si në terma financiare ashtu dhe në bazë abonentesh përkatës. Ky propozim është një vendim teper diskriminues dhe favorizon hapur dhe

ne menyre te pajustificuar dy operatoret Eagle Mobile dhe PLUS Communications ne dem te AMC. Eshte nje kthim prapa, pasi rregullimi dhe percaktimi i tarifave te terminimit te SMS-ve midis operatoreve ka qene gjithmone simetrik, si para ashtu dhe pas rregullimit te tregut te terminimit te SMS-ve. Per me teper AKEP gladpathin e 2011 e ka prothuar ne baze te analizes se kostove me mmodelin BULRIC dhe vendosi qe te gjithë operatoret kane te njejten kosto. Nuk ka asnje model kalkulimi kostoje qe ten a tregoje se per operatorin Eagle mobile dhe Plus u rrit kostoje e SMS-ve dhe u zvogelua kostoja e SMS per AMC

AKEP nuk ka ofruar asnje lloj argument, fakti apo evidence, se ku e ka justifikuar nje propozim te tille dhe ne baze te kujt akti rregullator eshte bazuar ne ndermarrjen e ketij propozimi, pasi kjo eshte nje shkelje e te gjithë parimeve te kuadrit rregullator si te BE-se (Framework Directive) dhe te legjislacionit shqiptar: parimi i mos-diskriminimit, parashikuar ne *nenin 8, parag.3/c, Direktiva Kuader 2002/21, e ndryshuar*, ne te cilen citohet si me poshte:

“3. The national regulatory authorities shall contribute to the development of the internal market by inter alia:....c) ensuring that, in similar circumstances, there is no discrimination in the treatment of undertakings providing electronic communications networks and services”.

Propozimi per vazhdueshmerine e aplikimit te masave rregullatore per terminimin e SMS-ve nuk eshte me i nevojshem, pasi eshte rritur dukshem niveli i konkurrences ne treg, duke qene se kushtet e tregut kane ndryshuar. Ndaj, ne perputhje situaten dhe rrethanet ne te cilen ndodhet ky treg, AKEP duhet te rishikojë dhe njehere pozicionin e tij ne lidhje me aplikimin e masave rregullatore, pasi tashme ato rezultojne te panevojshme me situaten e aktuale te tregut.

Ne perfundim, AMC shprehet per lenien ne fuqi te tarifave aktuale terminuese prej 1.44 leke/SMS dhe te jete ne nivel rekomandues, e njejte per te gjithë operatoret, dhe gjithashtu heqjen e kontrollit te metejsheem te tarifave te terminimit per SMS-te, pasi tashme niveli i konkurrences ne treg eshte mjaft I larte dhe I kenaqshem, dhe nuk eshte me e nevojshme vazhdimi dhe implementimi i metejsheem i masave rregulluese, apo rendimi i metejsheem i tyre, sic eshte vendosja e asimetrise ne rregullimin e tarifave midis operatoreve, pasi kjo con ne kthim prapa ne kohe, duke demtuar tregun dhe operatoret qe cenohen nga keto masa, pasi kjo asimetri nuk eshte vene re as ne kohen kur ky treg ka qene i derregulluar perpara vitit 2011.

Pergjigje e Plus:

Alternativa e tretë qëndron realiste dhe i jep peshën e duhur secilit operator dhe ndihmesë për të pasur shërbime më konkurruese.

Pergjigje e VF:

15. Vodafone Albania konsideron se tarifat e terminimit, ne rast te nje rregullimi te mundshem te tregut te terminimit te SMS (i cili nuk duhet), duhet te jene simetrike dhe se asnje prej operatoreve ekzistues nuk duhet te perfitoje favore te pamerituara ne menyre diskriminuese ne lidhje me tarifat e terminimit te SMS-ve ne rrjetin e tyre. Nga ana tjeter eshte e pahasur me pare ne vendet e tjera qe te aplikohet asimetri terminimi per tarifat e SMS dhe aq me teper kur rregullimi ne vetvete ka filluar me simetri te plote. Asimetria, ne ato pak raste te kufizuara lejimi, eshte perdorur per thirrjet zanore, eshte e kufizuar ne kohe dhe u jepet vec operatoreve te sapohyre ne treg, dhe ky nuk eshte kurrsesi rasti me operatorin Plus (prej 4 vjetesh ne treg) apo aq me teper me operatorin Eagle Mobile (prej 7 vjetesh ne treg).
16. AKEP justifikon nderhyrjen e diferencuar ne tregun e terminimit te SMS me qellim qe te arrije nje perfitim me te balancuar edhe per SMS qe dergohen jashte rrjetit – pra duke gjykuar se keto kane nje cmim me te larte sesa SMS qe dergohen brenda rrjetit. Me kete logjike, nese AKEP vertet kerkon te arrije nje rezultat te tille, atehere do te duhej qe te mos zbatonte fare asimetri mes tarifave te terminimit por tibarazonte teresisht ato, perndryshe SMS e derguar drejt rrjetit me tarife me te larte terminimi do te jene gjithmone me te shtrenjta dhe nuk do te realizohet qellimi i siperpermendur rregullator. Ngjashmerisht i njejti problem po evidentohet sot edhe me asimetrinee lartete zbatuar per terminimin zanor.
17. Per sa me lart Vodafone kerkon de-rregullimin e tregut te terminimit te SMS dhe heqjen e rregullimit te pershkallezuar te tarifave te terminimit. Sidoqofte ne kushtet e nje rregullimi te mundshem (i cili

nuk duhet) Vodafone mbeshtet Alternativen nr 1 (ruajtje e tarifave aktuale) deri ne kushtet kur te jete kryer nje analize e kostove ne menyren e duhur dhe me transparencen e bashkepunimin e te gjithë operatoreve ne treg.

Qendrimi AKEP:

AKEP pas ka marre ne konsiderate komentet e operatoreve si dhe praktiken ne vendet e Evropes per rregullimin e terminimit te SMS-ve, ka vendosur qe te ruaje simetrine e tarifave midis operatoreve dhe te aplikojë nje reduktim me 31%, nga 1.44 lek/sms ne 1.00 lek/SMS duke filluar nga 1.04.2014. Afati i fillimit te aplikimit te tarifës se re te terminimit te SMS-ve eshte percaktuar data 1.04.2014, e njejte me daten e fillimit te reduktimit te tarifave te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare te percaktuar nga AKEP ne dokumentin dhe vendimet perkatese per *“Rishikimin e tarifave te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare”*.

Vleresohet se kjo mase rregullatore do te mundesoje nje mjedis me te ekuilibruar ndermjet operatoreve duke krijuar stimuj me te rritur per ofrim tarifash me te lira ne nivel me pakice, sidomos per tarifate standarte/nominale (jo te perfshira ne bundles) per SMS jashte rrjetit (off-net).